

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7679 E diel 14 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

**N**ë një kohë kur vendet e rajonit po investojnë në fushën e arsimit dhe zhvillimit arsimor, qeveria "Rama" e ka shpallur armik djën dhe arsimin ...  
Vijon në faqen 21

Nga JORIDA TABAKU

Diktatura e propagandës nuk e do arsimin!



Opinion **i** Ditës

Nga KAY-ALEXANDER SCHOLZ

**D**isa analistë e vlerësuan pozitivisht fjalimin e Merkelit në fundjavën që shkoi para rinisë së partisë konservatore, CDU. Ajo i bëri të rinjtë të duken ...  
Vijon në faqen 22

Vjeshta e stuhishme e Angela Merkelit



Mat/ Vrasësi s'jep shenja pendimi

## "Ngujohen" të afërmit e njeriut që vrau 3 veta: Kujtimi na mori fytyrën

51-vjeçari "justifikohet" para policisë: Njëri më ofendoi dhe qëllloi me shuplakë

ENVER DOÇI & TRENDAFIL VISHA

"Kujtimi na ka marrë fytyrën. Na ka turpëruar jo vetëm këtu në fshat e në zonë, por në të gjithë vendin. Që nga dita kur ndodhi ngjarja, ne nuk guxojmë të dalim as tek oborri i shtëpisë. Nuk e dimë pse e bëri dhe si ..."

Në faqen 7

## VENDIMI/ NIKO LERA: MBETEN BINGOT TELEVIZIVE DHE LOTARIA KOMBETARE

# NGA 1 JANARI 'ZHDUKEN' EDHE BASTET "ONLINE"

Drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave, në "News 24": Plani ynë që njerëzit të mos mbeten pa punë. Kazinotë, transferim në hotelet me 5 yje



(Në foto) Drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave, Niko Lera

INTERVISTA

**Shpëtim Idrizi:**  
Parti klienteliste?  
PDIU-ja nuk pati kurrë një ministër

Në faqet 8-9

PARALAJMERIMI

**"Gjohë kush shpi!",**  
Rama: Do paguani.  
PD dhe LSI: Rikthim në kohën e etërve

Në faqen 3

PRESIDENTI

**Meta në Tropojë**  
vlerëson Azemin dhe Berishën për dhjetorin e '90

Në faqen 5

MBYLLEN HETIMET

**Trafikuan 10 tonë hashash në Itali,**  
gati gjyqi për 25 doganierë e policë

Në faqen 6

"MILOSAO"



**Fati i Lidhjes së Prizrenit dhe spekulimi me një mbledhje të 2014**

Suplement

Dokumentet e Ervin Saliqit: Fluturoi me trafikantin e drogës Edmond Bego

## PD: Udhëtore me kriminelët. Balla: Ju padis

Deputeti demokrat: 18 herë me çarter. Kreu i grupit të PS: Shpifje

Nga VALENTINA MADANI

**D**eputeti demokrat, Ervin Saliqi akuzoi djë deputetin socialist, Taulant Balla se ka bërë disa udhëtime bashkë me ish-trafikantin e drogës, Edmond Bega. Saliqi tha se faktet i ka siguruar nga sistemi TIMS dhe janë provë e lidhjeve



të ngushta të Ballës me ish-trafikantin e drogës, Edmond Bega, me të cilin ka udhëtuar dhjetëra herë jashtë vendin. "Deputeti socialist, Taulant Balla rezultoi të ketë udhëtuar jashtë vendit mbi 25 herë me trafikantin e drogës, Edmond Bega. Është fakt që ..."

Në faqen 4

## QEVERISJA AKUZAT

Kriminaliteti, kreu i PD: Nuk ndalemi deri në largimin e kimit nga politika

# Kthimi i dënimit me vdekje, Basha: Referendum, e vendosin shqiptarët

*Te familjarët e viktimave në Mat: Rama të shkyçë gojën*

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha nuk e përjashton kërkesën për rikthimin e referendimit për dënimin me vdekje, për shkak të situatës së rëndë të kriminalitetit në vend. Pas vizitës në familjet e viktimave të masakrës që ndodhi së fundmi në Mat, ku një banor vrau tre punonjësit të bashkisë, kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha tekta e cilësoi ngjarjen një tjetër tregues të kapitullimit total të shtetit, iu përgjigj interesit të medias, nëse duhet të rikthehet dënimi me vdekje. Sipas kreu të opozitës, kjo është një çështje që u takon shqiptarëve ta vendosin, apo ai thekson se është i gatshëm ta shtrijë në kuadrin e një referendumi. "Kjo është një çështje që u takon qytetarëve shqiptarë, por unë personalisht jam i gatshëm që të pyetje t'ia shtrij popullit shqiptar qoftë edhe si referendum në momentin që PD do marrë përgjegjësinë për të qeverisur vendin", - theksoi kreu i PD-së.



Kryetari i opozitës, Lulzim Basha

vani.

### MASAKRA

Kreu i PD-së nga spitali, ku kishte vizituar të plagosurin tregoi se kishte qenë edhe në familjet e të vrarëve dhe shpreh ngushëllimin, duke thënë se kjo është një ngjarje e rëndë, duke i vendosur epitetin makabër. Kryetari i PD-së i bëri thirrje kreu të qeverisë të reagojë lidhur me rastin. "I bëj thirrje kryeministrit ta

shkyçë gojën që e përdor vend e thellë që ndjejnë qytetarët e Matit", tha Basha. "Dua t'u jap një mesazh kuraje dhe force qytetarëve të Matit dhe prej Matit gjithë Shqipërisë, për betejën që do ftojme së bashku për largimin e kimit nga politika. Largimin e kimit nga rrugët, sheshet dhe nga qeveria për ta çuar atë ku e ka vendin, para drejtësisë dhe prapa hekurave", deklaroi z.Basha.

jen e thellë që ndjejnë qytetarët e Matit", tha Basha. "Dua t'u jap një mesazh kuraje dhe force qytetarëve të Matit dhe prej Matit gjithë Shqipërisë, për betejën që do ftojme së bashku për largimin e kimit nga politika. Largimin e kimit nga rrugët, sheshet dhe nga qeveria për ta çuar atë ku e ka vendin, para drejtësisë dhe prapa hekurave", deklaroi z.Basha.

## "Luksi i vajzës, makiazh i dhunës së Rexhepit"

### Zhupa: Shfaqja e fundit e Xhisielës, e detyruar të tërheqë denoncimin?

Demokratët përmes zëdhënësës Ina Zhupa reagon dje pas kërkesës së Rexhep Rajës për liri. Duke u ndaluar të shfaqja e fundit në publik e Xhisielës, Zhupa ngre dyshime se Xhisiela Maloku mund të jetë kërcënuar përsëri. "Rexhep Rajja ka kërkuar lirinë me pretekstin se Xhisiela ka tërhequr denoncimin! Po pse Xhisiela e paska tërhequr përsëri denoncimin? A u kërcënuar përsëri ajo? A u vërtetua



vallë se cigaren e kishte fiksuar vetë në trupin e saj? Xhisiela Maloku u filmua së fundmi teksa drejtoje një makinë të vitit 2017, që kushton mijëra euro. Gjithashtu, gazetaret

vunë në dukje celular 'iPhone X' dhe syze 'Gucci', që po ashtu kushtojnë qindra euro. Ku mund t'i ketë gjetur Xhisiela kaq shumë para?! A janë këto indicie se Xhisiela Maloku e kanë detyruar të tërheqë denoncimin dhe a janë përfshirë nga prokuroria në hetim", shkruan Zhupa në një postim në "Facebook". Sipas saj: "Me Edi Ramën në krye të institucioneve, krimi është gjithmonë i pajfishëm dhe viktimat fajtor".



Cjatë një seance parlamentare

### SHKURT

## Ish-ministri: Nëse opozita ulet me Ramën, Balla është i pari që e ha

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, dje në emisionin "Kjo Javë", në "News 24" u shpreh se kryeministri është sot nervoz, pasi nuk po gjen dot mekanizmin për të parë opozitën dhe parlamentin e ka bosh. "Opozita ka ende punë për të bërë, duhet racionalizuar mirë jo vetëm reagimi opozitar, por edhe përgatitja për të qeverisur nesër. Në këtë nervozitet Rama hedh shashka. Unë mendoj se me këtë qeveri nuk ka asnjë arsye për t'u ulur, por e zëmë se për një moment të caktuar, opozita ulet me Ramën, Taulant Balla është i parë që e ha nga Rama vetë. Fatmir Xhafaj nuk e shtyn dot më, jo vetëm për arsye të brendshme, por edhe për arsye ndërkombëtare. Ka ardhur edhe memoja e Fatmirit, e di ai shumë mirë, siç erdhi për Saimirin. Dhe hedh karrema për opozitën, po ju jap KLSH, po ju jap SHIK-un, përpiqet për të futur opozitën të logjika e pazarit politik dhe nëse partitë e opozitës së sotme bien në këtë logjikë, do bëjnë gabimin më të rëndë të mundshëm dhe do jetë me pasoja shumë të rënda për demokracinë në Shqipëri", theksoi Manjani.

## "Vrasja në Mat", Xhaçka: Barbare, Zoti iu dhëntë forcë familjeve

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka vizitoi familjet e tre të vrarëve në Shëllë, Burgajet dhe Zenisht të Matit. Ajo shpreh ngushëllime në familjet, ndërsa vlerësoi punën e të vrarëve në shërbim të komunitetit. Ministria Xhaçka shpreh bindjen se drejtësia do të bëjë punën e saj dhe se autori do të marrë dënimin e merituar. Ministria Xhaçka vlerësoi punën e tre punonjësit të bashkisë, të cilët ranë në krye të detyrës duke ndërtuar rrugët e fshatrave. Ajo e cilësoi ngjarjen si barbare, ndërsa u shpreh se duhet forcë për të tejkaluar këtë "masakër" të ndodhur në rrethin e Matit. "Kjo është një ngjarje barbare, Zoti iu dhëntë forcë familjeve", theksoi ministria e Mbrojtjes.





Kryeministri dënon shpifjen: 'Gjysmagjela' politikë e mediatikë s'meritojnë as supë burgu

# Rama: Në BE shpifja dënohet me burg, për 'gjysmagjela' tanë gjobë

*"Do paguajnë gjobën e ndotjes për çdo fëlliqësirë"*

Kryeministri Edi Rama mbrojti sërish propozimin e tij për hartimin e një ligji që dënon shpifjen. Në kohën kur ka vendosur që ai dhe përfaqësuesit e partisë së tij të denoncojnë çdo akuzë që do ta cilësojnë si shpifje, kryeministri Edi Rama thotë se kjo e fundit në vendet e Bashkimit Europian dënohet deri në 25 vjet burg. Megjithatë, ashtu siç ka përsëritur edhe në të shkuarën, kreu i qeverisë thotë se ata që shpifin nuk meritojnë që të shkojnë në burg, duke ritheksuar se "gjysmagjela" nuk meritojnë as 1 supë burgu". Dënimi për ta do të jetë gjoba. "Shpifja dënohet me burg në 25 vende të BE! Gjysmagjela tanë të majmura nga xhepat e nga trutë, që kanë bërë karriera politike e mediatike duke sharë e akuzuar pa prova, s'meritojnë as 1 supë burgu! Ata thjesht do të paguajnë gjobën e ndotjes për çdo fëlliqësi që u nxjerr goja", shkruan kryeministri në një postim në "Twitter". Dy ditë më parë kreu i qeverisë tha se për çdo njëherë nga çështjet që do të fitojnë, do të kërkojë dëmshpërblim financiar. Të ardhurat do të shkojnë për një strukturë të re, që do të ngrihet nga shumica e që ai propozoi ta pagëzojnë si Fondi i Edukimit. Rama paralajmëroi gjithashtu ngritjen e një departamenti antishpifje në selinë roze, i cili do të koordinojë dhe ndjekë ecurinë e proceseve gjyqësore, që do të hapen për çdo shpifje ndaj socialistëve. Kryeministri deklaroi se do të hedhë në gjyq dhe do të kërkojë dëmshpërblim financiar për çdo politikën, gazetarin apo komentues të rrjeteve sociale, për çdo akuzë që socialistët mund ta cilësojnë si shpifje ndaj tyre. Ai njoftoi paktën antishpifje, ndërsa tha se çdo lek i fituar nga një gjyq për shpifje, do të shkojë në Fondin e Edukimit. "Çdo shpifje të hedhur në drejtimin tonë nga kazani



**TRITAN SHEHU**

"Sa vite burg do të vendosë kryeministri në paketën e tij antishpifje për atë që 'shpif' se çmimi stratosferik i naftës, rritja e mëtejshme e tij, cilësia e saj skandaloze, vijnë nga taksat e larta dhe aferat korruptive të qeverisjes?", - shkruan deputeti i PD-së.

## Deputeti i PD publikoi raportin e OSBE-ODHIR

Bylykbashi: Ndërkombëtarët janë kundër paketës antishpifje të Ramës

Nuk janë vetëm shqiptarët dhe opozita kundër të ash-tuajturës paketë antishpifje, të propozuar nga Edi Rama, por edhe ndërkombëtarët. Deputeti i Partisë Demokratike, Oerd Bylykbashi, publikoi dhe raportin e OSBE-ODHIR-it, në të cilin thuhet qartë se askush nuk mund të pengojë të drejtën dhe lirinë e shprehjes tek qytetarët. Ndërkohë që kryeministri Edi Rama ka vendosur që askush të mos flasë më kundër qeverisë së tij dhe askush të mos denoncojë skandalet e mëdha qeveritare si dhe lidhjet e politikës me krimin dhe këtë kërkon ta bëjë përmes paketës antishpifje. "Ndërkombëtarët, kundër paketës antishpifje të Ramës. ?Të nderuar gazetarë, kjo është një kujtesë për ju se nuk jeni vetëm ata drejt autocensurës. Për këtë arsye, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës. Rezoluta 2019 (viti 2014)??. Zbatim i detyrimeve dhe angazhimeve nga Shqipëria??. Rekomandimi 5.4., Asambleja e Këshillit të Europës mirëpret shfuqizimin e dënimit me burg për fyerjen dhe shpifjen dhe shfuqizimin e mbrojtjes së veçantë për kategori të posaçme personash. Megjithatë, ajo shpreh keqardhjen që shpifja nuk është dekriminalizuar (hequr nga Kodi Penal) plotësisht dhe vazhdon të ketë një efekt frenues mbi gazetarët dhe mund t'i çojë ata drejt autocensurës. Për këtë arsye, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës i bën thirrje parlamentit të dekriminalizojë (heqë nga Kodi Penal) plotësisht shpifjen, në përputhje me standardet e Këshillit të Europës", shkruan z.Bylykbashi. Ai akuzon se, "që në vitin 2014, qeveria e Edi Ramës vazhdon të shkelë rekomandimet e Këshillit të Europës dhe OSBE. Përkundrazi, jo vetëm e ka përdorur Kodin Penal për të dënuar penalisht deputetët e opozitës, ka ndërsyer deputetët e tij për të kallëzuar penalisht deputetë dhe gazetarë për shpifje, për denoncinim që ata u bëjnë lidhjeve të tij dhe qeverisë së tij me krimin dhe korrupsionin, por kërcënon me paketë të re antishpifje si instrument për autocensurë, siç e quan Këshilli i Europës. Diktatura kundër lirisë së shprehjes është tek porta?! Ose flasim e ngrihemi sot kundër kësaj të keqeje, ose nesër është vonë!".

## BERISHA: RIKTHIM NË KOHËN E ETËRVE, XHELATË TË FJALËS SË LIRË

"Rikthim në kohën e etërve, xhelatë të fjalës së lirë". Kështu e cilësoi dje ish-kryeministri Berisha paketën antishpifje të njoftuar një ditë më parë nga kreu i qeverisë. Në një postim në "Facebook", Berisha publikoi edhe foton ku shkruhet se ai në qeveri ndaloj me urdhër padinë për shpifje ndaj çdo gazetari nga ministrat dhe deputetët e tij, ndërsa sot pasardhësi i tij, Edi Rama, urdhëron ministrat e deputetët që të padisin për shpifje çdo gazetë, gazetar, portal dhe individ.



"Me urdhër të kryeministrit Sali Berisha, asnjë gazetar apo politikan nuk u padit as civilisht nga

qeveria apo administrata për shpifje, edhe pse Kodi Civil ka dispozitat e nevojshme kundër shpifjes, pra nuk ka nevojë për rregulla shtesë", tha z.Bylykbashi.

## PETRIT VASILI

"Paketa antishpifje është një përzierje shumë e veçantë ndërmjet maskarallëkut dhe idiotsisë. Është një bashkim që i mishëron vetëm kryeministri, amalgamë mes maskarait dhe idiotit", deklaroi kreu i deputetëve të LSI-së.

politikë e mediatik, a qoftë edhe nga kazani i profilleve zyrtare digjitale, ne do ta padisim në gjykatë", - shkruante Rama në "Facebook". Të hënën, në mbledhjen e zgjeruar të grupit parlamentar do të prezantohet nisim "Çdo shpifje në fondin e edukimit". Paratë që socialistët do të fitojnë nga gjyqet e shpifjes, do të grumbullohen në Partinë Socialiste, ku do të ngrihet menjëherë departamenti antishpifje, i cili do të koordinojë dhe ndjekë ecurinë e betejës ligjore kundër shpifjes. Sipas idesë paraprake të Ramës, Fondi i Edukimit do të ketë një bord drejtues, i cili do të trajtojë propozimet e lartpërmendura si dhe do të jetë e vetmja instancë që mund të vendosë tërheqjen nga një proces gjyqësor për shpifje. Për opozitën, kjo është një strategji e Ramës për të larguar vëmendjen nga aktualiteti, pasi i pari që sipas tyre duhet të dënohet është vetë kryeministri.

## SKANDALI REAGIMET

PD publikon fakte për lidhjen e Ballës me Begon: 25 udhëtime me trafikantin e drogës

# Salianji: 600 mijë euro udhëtime. Balla: Të hënën, padi në gjykatë

## "Po kontribuon për Fondin e Edukimit"

Valentina Madani

Deputeti demokrat, Ervin Salianji aku zoi dje deputetin socialist, Taulant Balla se ka bërë disa udhëtime bashkë me ish-trafikantrin e drogës, Edmond Bega. Salianji tha se faktet i ka siguruar nga sistemi TIMS dhe janë provë e lidhjeve të ngushta të Ballës me ish-trafikantrin e drogës, Edmond Bega, me të cilin ka udhëtuar dhjetëra herë jashtë vendin. "Deputeti socialist, Taulant Balla rezultoi të ketë udhëtuar jashtë vendit mbi 25 herë me trafikantin e drogës, Edmond Bega. Është fakt që Taulanti nga Librazhdi, gjatë historikut të udhëtimeve, gjatë periudhës që qeveris Edi Rama ka përdorur plot 18 herë çarterin për udhëtime jashtë Shqipërisë, ku nuk mungojnë edhe udhëtime me çarter nën shoqërinë e trafikantit të drogës, Edmond Bega. Janë minimalisht 600 mijë euro udhëtime me çarter", deklaroi deputeti i PD-së. Demokratët shtruan disa pyetje, për të cilat kërkojnë përgjigjen e kryeministrit dhe vetë të akuzuarit prej tyre, Taulant Balla. "Ku i gjeti Taulant Balla paratë për udhëtime me çarter plot 18 herë? A janë financuar udhëtime të tij me çarter nga burime të paligjshme? Kush i ka paguar paratë për fluturimin me çarter të Taulant Ballës? Nëse i ka paguar vetë, cili është burimi i këtyre parave? Nëse i ka përfutur si dhuratë, kush është dhuruesi? A lejohet nga ligji përfutimi i dhuratave me këtë vlerë dhe a janë deklaruar ato në ILDKPKI?", shprehet z.Salianji. Demokratët e vlerësojnë si shantazh ndaj qytetarëve, opozitës dhe medias, iniciativën e shumicës për miratimin e një pakete antishpifjeje. E gjitha kjo, sipas tyre, bëhet në bashkëpunim me ata që i quajnë veglat e një prokurori, të cilët nuk hejtojnë dhe nuk dënojnë afer-



Deputeti i PD-së Ervin Salianji

at e përfaqësuesve të shumicës socialiste.

### REAGIMI

Kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, mohoi dje akuzat e Partisë Demokratike se ka shpenzuar 600 mijë euro për udhëtime, në 18 fluturime me çarter së bashku me biznesmenin Edmond Bega. Në

një reagim në rrjetet sociale, kreu i grupit parlamentar të PS shprehet se udhëtimet e pretenduara nga deputeti Ervin Salianji janë shpifje dhe paralajmëron padi ndaj këtij të fundit. "Lulzim, mjaft e shpërdorove Salianjin me shpifje, për udhëtime 18 herë me çartera. Informacioni është në 'Albcontrol'

dhe mund ta merrni. Pse nuk bëni kallëzim në prokurori?", deklaroi z.Balla. Kreu i deputetëve socialistë paralajmëroi se të hënën do të bëjë padi në gjykatë. "Megjithatë, faleminderit që po vijon të kontribuosh për Fondin e Edukimit! Të hënën padia në gjykatë!", shprehet z.Balla.

## Denoncimi i Salianjit, socialistja mbron Ballën

### Kushi: Në një nga udhëtimet me çarter isha unë dhe kryeministri

Deputetja socialiste, Evis Kushi reagoi dje pas denoncimit të bërë nga kolegu demokrat, Ervin Salianji, mbi udhëtimet e kreu të grupit parlamentar të PS, Taulant Balla me trafikantin e drogës. Referuar datave të një prej udhëtimeve në të cilat Salianji tha se Taulant Balla ka udhëtuar jashtë shtetit me trafikantin e drogës Edmond Bego, Kushi shkruan se bashkë me kryeministrin Rama, vetë ajo dhe deputetët Balla e Kryemadhi janë nisur për një udhëtim, vizitë pune, në Bruksel, në 8 dhjetor 2014, ora 12:23. "Lexova në media se deputeti Ervin Salianji, person në hetim 'për kallëzim të rremë në bashkëpunim' me Babalen', kishte hedhur



përsëri baltë pa pikë turpi mbi kryetarin e grupit dhe kolegun tim, Taulant Balla. Megenëse në një nga udhëtimet për të përfaqësuar Shqipërinë kam qenë edhe unë më datat 8-9 dhjetor 2014, e sqaroj opinionin publik që më datë 8 dhjetor 2014 ora 12:23 jemi nisur bashkë me kryem-

inistrin Rama, deputetët Taulant Balla, Monika Kryemadhi dhe unë për në Bruksel", - shkruan Kushi. Ajo i konsideron një genduri shpifjesh deklaratat e deputetit demokrat. Kushi i kujton atij paketën antishpifjeje të propozuar nga kryeministri Rama.



Presidenti Ilir Meta dje në Tropojë

### TAULANT BALLA

"Lulzim, mjaft e shpërdorove Salianjin me shpifje, për udhëtime 18 herë me çartera. Informacioni është në 'Albcontrol' dhe mund ta merrni. Pse nuk bëni kallëzim në prokurori? Faleminderit që po vijon të kontribuosh për Fondin e Edukimit! Të hënën, padia në gjykatë!", tha Balla.

## Të vegjlit: S'hyjmë në zgjedhje pa depolitizimin e KQZ-së

I zhgënjyer nga trezja konsultative për reformën zgjedhore, Koço Kokëdhima kërcënoi dje se partitë e vogla joparlamentare nuk do të marrin pjesë në zgjedhje, nëse nuk depolitizohet totalisht administrata zgjedhore, përfshirë KQZ-në. "Nuk do të pranojmë kurrë të futemi në zgjedhje dhe të marrim pjesë në votime kur votat tona i numërojnë Edi Rama dhe Lulzim Basha", deklaroi z.Kokëdhima. Kjo që po përgatitet sipas Kokëdhimës, është një farsë e re elektorale, e cila nuk është ajo që kërkon Bashkimi Europian për negociatat. "Në Tiranë nuk po përgatitet reforma e re zgjedhore, por farsa e radhës në zgjedhje", tha ai. Përfaqësuesi i Partisë Aleanca Demokratike, Eduard Abazi u bëri thirrje ndërkombehtarëve që të ndikojnë për një ligj të drejtë zgjedhor. "Ndërkombehtarët duhet ta besojnë tashmë se dakordësia me të mëdhenjtë nuk ka sjellë rezultat, ndaj ndikimi në rregullimet ligjore të garantojë zgjedhje të lira dhe me standarde", deklaroi z.Abazi. Në këtë tryezë morën pjesë disa përfaqësues të partive joparlamentare, të cilat përpiluan një deklaratë ku kërkojnë përfshirjen e tyre në procesin e reformës zgjedhore.







Presidenti në Tropojë, vlerëson Azemin dhe Berishën për rolin e tyre në tranzicion

# HEC-et në Valbonë, Meta: Të ruajmë ekosistemin nga projektet e nxituara

*"Tropoja i priu lëvizjes për rrëzimin e diktaturës"*

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta vlerësoi dje rolin e Tropojës për lirinë dhe pavarësinë, identitetin dhe dinjitetin kombëtar të vendit. Pa fshehur emocionin e veçantë, Ilir Meta u tha tropojanëve se malësia e Gjakovës përbën një epos plot histori dhe personalitete që i kanë dhënë shumë kombit shqiptar për lirinë dhe pavarësinë, për identitetin dhe dinjitetin kombëtar, për politikën dhe diplomacinë, për arsimin dhe shkencën, për artin dhe kulturën. Mbarë populli shqiptar i është mirënjohës popullit të Tropojës për atë çfarë i ka dhënë kombit. Ky vend është libër i një historie të madhe", deklaroi z.Meta. Kjo sipas tij, sepse tropojanët kanë qenë gjithmonë të shqetësuar për fatet e Shqipërisë e të shqiptarëve. "Tropojanët u gjenden dhe kontribuan në Lidhjen e Prizrenit, në Lidhjen e Pejës, në Lidhjen e Junikut, në Kuvendin e Vlorës, në Konferencën e Bujanit e në çdo ngjarje. Do të duhej një kohë e gjatë për të përmendur emrat e tyre me kontribute të paharruara për çështjen kombëtare si Haxhi Zeka, Bajram Curri, Binak Alija, Mic Sokoli Dervish Luzha e shumë të tjerë", deklaroi Ilir Meta. Kreu i shtetit theksoi veçanërisht rolin e personaliteteve të Tropojës në demokracinë e vendit, duke nënvizuar se dy udhëheqësit kryesorë të Lëvizjes Demokratike, Azem Hajdari dhe Sali Berisha ishin nga Tropoja. "Pësha që Tropoja dhe tropojanët kanë mbajtur në kapërcimin e jashtëzakonshëm nga diktatura në demokraci është e rrallë. Përkulëm me respekt e mirënjohje ndaj veprës së Azem Hajdarit, udhëheqësit të Lëvizjes Studentore. Nuk duhet të harrojmë se dy udhëheqësit kryesorë të Lëvizjes Demokratike si Azem Hajdari, ashtu edhe Sali Berisha ishin nga Tropoja. Po jo vetëm ata, edhe shumë të rinj të tjerë, edhe shumë personalitete të tjera, intelektualë si Besnik Mustafaj e shumë të tjerë ishin pikërisht nga Tropoja", theksoi Meta. Ai vlerësoi rolin e Berishës edhe për një nga veprat më strategjike në Shqipëri,



Rrugën e Kombit. "Nuk duhet të harrojmë se pa vendimarrjen dhe vendosmërinë e Sali Berishës, edhe sot Rruga e Kombit nga Tirana në Prishtinë mund të mos ishte bërë dhe shqiptarët do të vazhdonin të udhëtonin drejt një tjetrit përmes Maqedonisë", u shpreh z.Meta. Presidenti përmendi se Tropoja ka qenë dhe vazhdon të mbetet një krahinë me rëndësi strategjike mbarëshqiptare dhe fqinjësore. Presidenti nuk anashkaloi edhe debatin e madh

rreth ndërtimit të HEC-ve në Valbonë. "Ekosistemi i beshkëve të veriut është një nga pasuritë më të mëdha natyrore e turistike të popullit shqiptar. Këtë ekosistem duhet ta ruajmë me çdo mjet nga projektet e nxituara, të pamenduara, të shtytra nga politikëditore, por edhe interesat e çastit. Tropoja është një trevë e jashtëzakonshme thesari kulturor kombëtar. Zoti e bekoftë këtë vend të mrekullueshëm dhe popullin e mrekullueshëm të Tropojës!",

u shpreh z.Meta. Në vijim të vizitës së tij në Tropojë, presidenti u prit nga kryetari i bashkisë, Besnik Dushaj, i cili i uroi mirëseardhjen dhe e falënderoi për këtë vizitë. Pas takimit, Presidenti Meta vendosi një kurorë me lule dhe u përkul me nderim para memorialit të udhëheqësit të Lëvizjes Studentore dhe Dëshmorit të Atdheut, Azem Hajdari. Vizita e presidentit vijoi në "Festën e Gështenjës", që është kthyer në një veprimtari tradicionale për këtë qytet çdo vit në tetor, muajin e vjeljes së gështenjës. Gjatë "Festës së Gështenjës", presidenti vlerësoi "Unionin Artistik të Kombit Shqiptar" me titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut" si dhe dekoroi regjisorin Llesh Nikolla dhe balerinën e valltaren, Enida Çami. Presidenti mori pjesë edhe në ceremoninë e përirimit të punimeve të ish-hotel "Valbonës" ("Turizmi i vjetër) në Valbonë, duke u ndalur më pas në një takim pune me operatorët turistikë si dhe me shoqatat e turizmit në Valbonë. Meta vlerësoi disa personalitete të spikatura të artit, kulturës dhe gazetarisë të Tropojës, z.Islam Lauka, z.Ndue Smail Ukcama, z.Skënder Zeqir Dezhani, Murat Ali Hajdarin (pas vdekjes), z.Skënder Ram Haklaj si dhe Xhevhajr Elez Gashin (pas vdekjes).

**VLERËSIMI**

Meta vlerësoi rolin e Berishës edhe për një nga veprat më strategjike në Shqipëri, Rrugën e Kombit. "Nuk duhet të harrojmë se pa vendimarrjen dhe vendosmërinë e Sali Berishës, edhe sot Rruga e Kombit nga Tirana në Prishtinë mund të mos ishte bërë dhe shqiptarët do të vazhdonin të udhëtonin drejt njëri-tjetrit përmes Maqedonisë", u shpreh z.Meta.

**Ruçi: Dritëro Agolli i dhuroi fisnikëri sallës së mërzitshme të parlamentit**

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, mori pjesë dje në festën e 87-vjetorit të Dritëro Agollit, në Menkulas të Devollit. Në fjalën e tij përpara të pranishmëve, Ruçi vlerësoi rolin e shkrimtarit të madh goftë në fushën politike, goftë në atë të letrave shqipe. "Dritëro u bë shenjt i botës së letrave shqipe. Nëse dikush mendon se mund ta arrijë Dritëronë si shkrimtar dhe poet, kjo nuk mund të ndodhë. Por edhe nëse dikush shprehet se mund ta konkurrojë Dritëronë si politikan, përsëri e ka të vështirë, madje të pamundur. Sepse Dritëro është deputeti më jetëgjatë, rreth 30-vjeçar, në të dy kohërat dhe rrallëkush si ai i dhuroi fisnikëri sallës së mërzitshme të parlamentit. Sepse shkrimtari dhe politikani Dritëro u ngjizën në simbiozë dhe rrallëkush si ai guxoi që me veprën e vet të na tregojë 'Shqipërinë alternative' si nën monizëm, ashtu edhe në demokraci. Sepse Dritëro është borizani që u priu socialistëve shqiptarë drejt shndërrimit në një forcë politike e demokratike të majtë dhe e inspiroi atë të bëhet partia më progresiste e vendit", theksoi kreu i Kuvendit. Elona Agolli, vajza e shkrimtarit, shprehu mirënjohjen për të gjithë dashamirësit dhe miqtë e Dritëroit dhe falënderoi organizatorët e kësaj feste të bukur. Ajo tha se kjo datë e bëri Devollin të ndihet "toka e shenjtë". "Ka qenë dhe do mbetet përjetësisht si data e shenjtë, e cila solli në jetë njeriun që më shumë se mijëra fletë dhe tekste historie, e bëri Devollin të ndihet toka e shenjtë", deklaroi Elena Agolli.

**"Emërime politike dhe mungesë e meritokracisë"**

**Tabaku: Diktatura e propagandës ka e shpallur armike dijen**

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, shprehet se qeveria "Rama" e ka shpallur armike dijen dhe arsimin. "Në një kohë kur vendet e rajonit po investojnë në fushën e arsimit dhe zhvillimit arsimor, qeveria 'Rama' i ka shpallur armik dijen dhe arsimin. Tashmë është praktikë e qeverisë 'Rama' që të buxhetojë shumë herë më pak se sa qeveritë e shkuara për arsimin", shkruan ajo. Ndryshe nga dy vite më parë, Tabaku paralajmëron se vlerësimi i PISA do të jetë negativ. "Para dy vjetëve qeveria e Rilindjes 'Rama' rrihte gjoksin për arsimin dhe qeverisë demokratike, që u vlerësua edhe nga sistemi PISA. Por, është shumë e qartë që me mung-



esën e mësuesve cilësorë, emërimeve politike dhe mungesës së meritokracisë shoqëruar me kushtet e turpshme infrastrukturore, vlerësimi i PISA do të jetë negativ për rinjtë e shkolluar në periudhën e errësirës 'Rama 1' dhe 'Rama 2', shton Tabaku. Teksa vlerëson në gjendje të

mjeruar arsimin parauniversitar në Shqipëri, ajo thekson se gjendja në ciklin e lartë arsimor është edhe më lehtësitë. "Kryeministri i cili përpigjet të shfaqë kulturën dhe civilizimin e tij për të mbuluar dëshitimën e tij në arsimin e lartë, nuk mund të fshihet dëshitimën e turpshëm të reformës në arsim. Një reformë që mbylli 130 shkolla, 20 degë dhe që shtyu të rinjtë të largohen", shkruan Tabaku, duke shtuar se edhe ata pak studentët që vijnë në universitetet shtetërore përballen me tarifa marramendëse, që rriten përviut ndërsa familjet shqiptare varfërohen për vit. Një tjetër abuzim sipas saj është edhe rritja e çmimeve të librave.





Policia në vilën që po vidhej

## Kapen duke vjedhur vilën në Ishull-Shëngjin të Lezhës, arrestohen babë e bir nga Kurbin

**LEZHË** - Policia e Lezhës ka finalizuar operacionin e koduar "Vila", ndërsa ka arrestuar në flagrancë duke grabitur në një vilë babë e bir. Bëhet fjalë për 42-vjeçarin Bardhok Miza dhe djalin e tij E.M. 17 vjeç, banues në Kurbin. Mësohet se dy autorët e dyshuar janë kapur në momentin që po nxirrin materialet nga vila e sh-

tetasit N.K. në Ishull-Shëngjin të Lezhës për t'i transportuar. Blutë bëjnë me dije se në banesë nuk kishte njeri, ndërsa janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale edhe pajisjet shtëpiake që po tentonin të vidhnin si frigorifer, tavolinë, karrige, lavatrice, disa vegla pune dhe pajisje të tjera shtëpiake. Gjithashtu, policia

ka bërë të mundur dokumentimin edhe të disa vjedhje të tjera të ndodhura më parë, pas të cilave dyshohet se janë babë e bir. Mësohet se më datë 27 shtator ata dyshohet se kanë vjedhur me thyerje marketin në pronësi të E.L., në Shënkoll-Lezhë. Ndërsa më datë 9 tetor, dyshohet të kenë vjedhur dyqanin e elektrosht-

tëpiakeve në pronësi të M.Xh. në Lezhë. Materialet procedurale në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Lezhë për veprën penale "Vjedhje" kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Gjatë operacionit të efektivëve të Lezhës u shoqëruan gjithashtu për verifikim 7 persona të tjerë, kryesisht me precedentë penalë të mëparshëm për vjedhje dhe armëmbajtje pa leje.

## Lënda narkotike me vlerë 80 milionë euro u sekuestrua në Ankona

TIRANË

# Trafikuan 10 tonë kanabis në Itali, mbyllën hetimet për 25 doganierë e policë

Prokuroria për Krimet e Rënda ka dërguar për gjykim 25 doganierë dhe policë, të cilët akuzohen se lejuan të kalonin 2 kamionë me rreth 10 tonë drogë vitin e kaluar përmes Portit të Durrësit. Droga me vlerë 80 mln euro u sekuestrua nga policia italiane në Ankona. Sipas TV "Klan", tashmë organi i akuzës ka mbyllur hetimet për Florenc Tresën, që akuzohet për veprën penale "Trafikim i narkotikëve" i kryer në bashkëpunim. Tresa ka pasur rolin e trafikantit, ndërsa doganierët dhe policët bënë të mundur kalimin e kamionëve në doganë. 25 të arrestuarit janë punonjës të doganave dhe të policive kufitare Qafë-Thanës, Durrës dhe të Doganës së Vorës. "Prokuroria ka mbyllur hetimet edhe për punonjësit e doganave dhe policëve kufitarë Lirim Halili, Syrja Terziu, Çlirim Pepa, Ervin Kodra, Ilias Malja, Ymer Billosmi, Ilir Spahiu, Maliq Kadilli, Kastriot Topalli, Vladimir Ziu, Elis Deliu, Ylli Vogli, Erald Kulla, Edmond Luzi, Argorn Kapllani, Gëzim Dervishi, Roland Metani, Gentian Selmani, Mehdi Demiri, Mexhit Xhixha, Nezir Bardhoshi, Julian Dorci, Fatmir Plaku dhe Behar Sula", thuhet në njoftimin e organit të akuzës. Këta persona kanë pasur funksione si punonjës doganorë të doganave Qafë-Thanë, Vorë, Durrës, si dhe punonjës të policisë kufitare të Pikës së Kalimit Kufitar Qafë-Thanë dhe pranë Portit të Durrës, të akuzuar për veprën penale "Shpërdorim detyre" e kryer në bashkëpunim. Sipas prokurorisë, këta persona kanë lejuar kalimin e të paktën 10 tonëve kanabis me kamion drejt Italisë në dy raste. I pari lidhet me kapjen në Ankona, më 5 shkurt të këtij viti të një kamioni me 8.8 tonë kanabis, i futur në Shqipëri nga Maqedonia. Ndërsa ngarkesa e dytë prej 2.2 tonë kanabis u sekuestrua në 24 mars në Itali.

10

TONË

Sipas prokurorisë, 25 doganierë dhe policë kanë lejuar kalimin e të paktën 10 tonëve kanabis me kamion drejt Italisë në dy raste. I pari lidhet me kapjen në Ankona, më 5 shkurt të këtij viti të një kamioni me 8.8 tonë kanabis, i futur në Shqipëri nga Maqedonia. Ndërsa ngarkesa e dytë prej 2.2 tonë kanabis u sekuestrua në 24 mars në Itali.



Prokuroria e Krimeve të Rënda

### SHKURT

#### 'Xhisiela', Rexhep Raja kërkon lirinë në Apel

**TIRANË** - Pak ditë pasi Rexhep Raja, djali i deputetit të PS-së, Rrahman Raja, apeloj masën e arrestit me burg, "Gazeta Shqiptare" mëson treshen e gjyqtarëve që do të shqyrtojnë ankimmimin. Mësohet se trupa gjyqese do të kryesohet nga gjyqtarja Shpresa Beçaj, ndërsa anëtarët janë Ridvan Hado dhe Zeqine Sollaku. Procesi gjyqësor pritet të mbahet të mërkurën në Gjykatën e Apelit në Tiranë. Rexhep Raja u arrestua më 30 shtator, pas urdhrat të Gjykatës së Krutës, e cila dha "Arrest me burg, në mungesë" për të riun e akuzuar për "përndjekjen" e ish-të dashurës së tij, Xhisiela Malokut. Ndërkohë më 2 tetor, ai doli para Gjykatës në Krutë për t'u njohur me masën e sigurisë.

#### Prokurorja Arta Marku hap garën për KLP-në

**TIRANË** - Për shkak se vetëm një prej prokurorëve kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë kaloi sitën e vetingut, Prokuroria e Përgjithshme ka rihapur sërish garën për këtë institucion. Në thirrjen e publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni ftohen prokurorët të kandidojnë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Këshilli do të ketë 6 anëtarë prokurorë, nga të cilët 1 nga Prokuroria e Përgjithshme, 2 anëtarë nga Prokuroritë e Apelit dhe 3 anëtarë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.

#### Vrau me thikë të riun, në pranga 25-vjeçari

**TIRANË** - Dy ditë pas vrasjes me thikë të 30-vjeçarit Holti Hajdari në rrugën "Bego Hoxha" në Kombin, policia ka arrestuar autorin e dyshuar të ngjarjes. Policia bën me dije se është vënë në pranga Muhamet Sallahi, 25 vjeç, pasi mbrëmjen e 11 tetorit ka goditur me thikë disa herë 30-vjeçarin, duke i shkakuar vdekjen. Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë për veprën penale "Vrasja me dashje".

## Marku pret zyrtarët gjermanë: Njësi të përbashkëta investiguese

### Veliu-Henzler: Bashkëpunim me Gjermaninë në luftën ndaj krimit të organizuar ndërkombëtar



gjermanë është një bashkëpunim shumë serioz dhe konkret në drejtim të luftës ndaj paligjshmërisë. Bashkëpunimet e shumta me palën gjermane kanë qënë faktor kyç i suksesit në luftën ndaj krimit". Nga ana e tij, Henzler u shpreh se tashmë është ngritur një bazë e shkëlqyer për ta çuar më tej bashkëpunimin

mes dy policive, duke ndërmarrë iniciativat të përbashkëta në varësi të situatës së krimit në Shqipëri, në Gjermani dhe pse jo edhe më gjerë në Europë. Ndërsa, gjatë takimit me Prokuroren e Përgjithshme, Arta Marku, zyrtarët gjermanë u angazhuan për bashkëpunim në të gjitha rastet konkrete të

ndodhura në Gjermani, kurse prokuroria nga ana e saj që të plotësohet dokumentacioni dhe kërkesat e duhura ligjore. Rëndësi të veçantë iu dha krijimit të njëjësive të përbashkëta investiguese me shtetin gjerman dhe forcimit të luftës së përbashkët kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.



Vrasësi nuk pendohet. Të afërmit: E kemi bërë hasha, as në gjyq s'kemi për të shkuar

# "Kujtimi na turpëroi dhe na e mori fytyrën me masakrën që bëri, s'dalim dot as te pragu i derës"

*Familjarët e 51-vjeçarit: Jemi ngujuar në banesë. Edhe nëse na falin familjarët e viktimave, nuk mund t'u dalim para syve*

Enver Doçi  
Trëndafilë Visha

**MAT**  
"Kujtimi na ka marrë fytyrën. Na ka turpëruar jo vetëm këtu në fshat e në zonë, por në të gjithë vendin. Që nga dita kur ndodhi ngjarja, ne nuk guxojmë të dalim as tek oborri i shtëpisë. Nuk e dimë pse e bëri dhe si e bëri atë krim të tmerrshëm. Edhe sikur të na falin familjarët e viktimave, ne nuk mund t'u dalim më para syve". Kështu janë shprehur dje familjarët e 51-vjeçarit Kujtim Koxha nga fshati Shëlli i njësisë administrative Lis të Matit, i cili pasditen e së enjtes bëri masakër të vërtetë, duke vrarë me breshëri kallashnikovit tre punonjësit e bashkisë dhe duke plagosur një tjetër. Vrasja e trefishtë ka shokuar familjarët e vrasësit. Menjëherë pas ngjarjes ku mbetën të vrarë shtetasit Mentor Hoxha 36 vjeç, Erzen Aliaj 49 vjeç dhe Hamit Buçi si dhe mbeti i plagosur Astrit Hani, 40 vjeç familja Koxha është ngujuar. E ndërsa pjesëtarët e familjes Koxha kanë dënuar aktin e rëndë, vetë autori i krimit makabër nuk ka shprehur pendesë për marrjen e tri jetëve dhe lënien jetimë të viktimave. Dy ditë më parë ai është justifikuar para oficerëve të policisë gjyqësore me fjalët se njëri nga viktimat e kishte fyer dhe e kishte qëlluar me shuplakë. "Njëri nga ata më qëlloi me shuplakë dhe më tha je i dehur. Më pas nuk mbaj mend se çfarë ka ndodhur", është shprehur 51-vjeçari, i cili pohohet të jetë person problematik. Ndërkohë, burime zyrtare nga Prokuroria e Burrelit dje bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se të hënën do të jepet masa e sigurisë ndaj autorit të masakrës që tronditi gjithë opinionin publik, Kujtim Koxha. "Ne kemi mbledhur të gjitha materialet e duhura. kemi bërë dokumentimin e ngjarjes që ndodhi pak ditë më parë në fshatin Shëlli. Të hënën do të kërkohet masën e sigurisë 'Arrest me burg' ndaj autorit të krimit", tha prokurori i çështjes, Abaz



Autori i vrasjes së trefishtë, Kujtim Koxha



Lokali ku ndodhi krimi

## VIKTIMAT

### TË VRARË

1. Mentor Hoxha  
36 vjeç
2. Erzen Aliaj  
49 vjeç
3. Hamit Buçi  
52 vjeç

### I PLAGOSUR

Astrit Hani  
40 vjeç,

## NGUJIMI

Që nga momenti kur ndodhi masakra në lokalin e fshatit, ata janë ngujuar brenda katër mureve. Nuk guxojnë as të hapin telefonat dhe t'u përgjigjen njerëzve të afërm. Ndihën të turpëruar me të gjithë. E përveç turpit, ata i druhen hakmarrjes, "barrë" kjo e rëndë që ua vuri mbi shpatulla kryefamiljari, Kujtimi. Ende nuk duan ta besojnë atë që ka ndodhur. U ngjan si ëndërr e keqe dhe e frikshme. Dhe kur i "kthehen" realitetit, dridhen e nuk i mbajnë më këmbët. Afër banesës së tyre nuk lëviz as miza, përveç policëve që ruajnë non stop banesën.

## TURPI

Të kontaktuar dje nga "Gazeta Shqiptare", familjarët e 51-vjeçarit vrasës u shprehën se nga turpi nuk mund të dalim dot as deri te pragu i derës. "Ende nuk e besojmë dot atë që ndodhi. Nuk e besojmë, pasi njëri nga viktimat ka qenë shok i ngushtë i Kujtimit. E kemi fjalën për Hamit Buçi. Kujtimi rrinte përditë me të, ishin shokë e miq. Pinin e hanin bashkë. Nuk kemi se çfarë themi. Nuk na dalin fjalët nga goja. Kujtimi na turpëroi me banorët e fshatit. Na turpëroi në mbarë vendin. Këtë nuk ia kishim borxh", thanë pjesëtarët e familjes Koxha.

## BRAKTISJA

Pjesëtarët e familjes Koxha deklaruan se nuk do të shkojnë në gjyq (seancën gjyqësore) ku do të jepet masa e sigurisë. "Asnjëri nga ne familjarët nuk kemi shkuar për ta takuar që kur e arrestuan. Nuk kemi më punë me të. Na turpëroi keq, sa nuk mund të dalim më faqe botës. Edhe sikur të na falin familjarët e viktimave, ne nuk mund t'u dalim prej turpit para syve", u shprehën familjarët e autorit të krimit. Nga ana tjetër, ata thanë se, "Kujtimi duhet të vizitohet tek një psikiatër, pasi nuk gjejmë asnjë arsye, nuk gjejmë asnjë përse për atë që bëri".

## AUTORI

E ndërsa pjesëtarët e familjes Koxha kanë dënuar aktin e rëndë, vetë autori i krimit makabër nuk ka shprehur pendesë për marrjen e tri jetëve dhe lënien jetimë të viktimave. Dy ditë më parë ai është justifikuar para oficerëve të policisë gjyqësore me fjalët se njëri nga viktimat e kishte fyer dhe e kishte qëlluar me shuplakë. "Njëri nga ata më qëlloi me shuplakë dhe më tha je i dehur. Më pas nuk mbaj mend se çfarë ka ndodhur", është shprehur 51-vjeçari, i cili pohohet të jetë person problematik.

## VARRIMI

Mesditën e së premtes iu është dhënë lamtumira e fundit viktimave Mentor Hoxha 36 vjeç, Erzen Aliaj 49 vjeç dhe Hamit Buçi. Ceremonitë e varrimit janë bërë në tri fshatra. Kjo për faktin se ata jetonin në fshatra të ndryshme, konkretisht në Zonisht, Burgajet, Shëlli. Në varrimin e viktimave kanë marrë pjesë qindra njerëz, stafi i Bashkisë së Matit, përfaqësues të PD-së, PS-së si dhe deputeti i LSI-së, Përparim Spahiu. Të premtën ka mbërritur në Mat edhe kreu i PD-së, Lulzim Basha, i cili ka vizituar dhe ka ngushëlluar familjarët e tre të vrarëve.

Muça. Nga ana tjetër, mësohet se policia ka marrë në mbrojtje familjen e autorit të vrasjes së trefishtë duke kryer shërbim pengjati 24 orëve, pasi i druhen një hakmarrjeje të mundshme atë që ka ndodhur. U ngjan si ëndërr e keqe dhe e frikshme. Dhe kur i "kthehen" realitetit, dridhen e nuk i mbajnë më këmbët. Afër banesës së tyre nuk lëviz as miza, përveç policëve që ruajnë non stop banesën.

## REAGIMI I FAMILJARËVE

Mesditën e së enjtes ua ka rrëzuar "qiellin" sipër kokës pjesëtarëve të familjes Koxha dhe të afërmeve të tyre. Që nga momenti kur ndodhi masakra në lokalin e fshatit, ata janë ngujuar brenda katër mureve. Nuk guxojnë as të hapin telefonat dhe t'u përgjigjen

njerëzve të afërm. Ndihën të turpëruar me të gjithë. E përveç turpit, ata i druhen hakmarrjes, "barrë" kjo e rëndë që ua vuri mbi shpatulla kryefamiljari, Kujtimi. Ende nuk duan ta besojnë atë që ka ndodhur. U ngjan si ëndërr e keqe dhe e frikshme. Dhe kur i "kthehen" realitetit, dridhen e nuk i mbajnë më këmbët. Afër banesës së tyre nuk lëviz as miza, përveç policëve që ruajnë non stop banesën. Pas ngjarjes së rëndë, ata deklaruan se e kanë bërë "hasha" 51-vjeçarin Kujtim Koxha. Thanë se e kanë braktisur në "fatin" e tij.

Bashkë me të rriturit, në banesë janë ngujuar edhe fëmijët, të cilët nuk kanë shkuar në shkollë. Të kontaktuar dje nga "Gazeta Shqiptare", familjarët e 51-vjeçarit vrasës u shprehën se nga turpi nuk mund të dalim dot as deri te pragu i derës. "Ende nuk e besojmë dot atë që ndodhi. Nuk e besojmë, pasi njëri nga viktimat ka qenë shok i ngushtë i Kujtimit. E kemi fjalën për bashkëfshatarin tonë, Hamit Buçi. Kujtimi rrinte përditë me të, ishin shokë e miq. Pinin e hanin bashkë. Edhe atë ditë që ndodhi gjëma, bashkë kanë qenë e

bashkë kanë pirë. Nuk kemi se çfarë themi. Nuk na dalin fjalët nga goja. Kujtimi na turpëroi me banorët e fshatit, me banorët e fshatrave të tjerë nga janë tre të tjerët, dy prej të cilëve mbetën të vrarë dhe një i plagosur. Na turpëroi në mbarë vendin. Këtë nuk ia kishim borxh", thanë familjarët e autorit të masakrës. Ndërkaq, ata pohuan se nuk guxojnë të hapin as telefonat. "Na marrin të afërm e të njohur në telefon dhe nuk u përgjigjem. Na vjen zor", thanë pjesëtarët e familjes Koxha. Gjithashtu, ata de-

klaruan se nuk do të shkojnë në gjyq (seancën gjyqësore) ku do të jepet masa e sigurisë. "Asnjëri nga ne familjarët nuk kemi shkuar për ta takuar që kur e arrestuan. Nuk kemi më punë me të. Na turpëroi keq, sa nuk mund të dalim më faqe bote. Edhe sikur të na falin familjarët e viktimave, ne nuk mund t'u dalim prej turpit para syve", u shprehën familjarët e autorit të krimit. Nga ana tjetër, ata thanë se, "Kujtimi duhet të vizitohet tek një psikiatër, pasi nuk gjejmë asnjë arsye, nuk gjejmë asnjë përse për atë që bëri".



# MARRËVESHJA

## INTERVISTA

Kreu i PDIU: Bushati para 1 viti desh u anëtarësua në shoqatë si çam i konvertuar

# Çështja çame, Idrizi: Harta që po i merr det e toka Shqipërisë

“Ne nuk harrojmë as miqtë, as armiqtë tanë”

Valentina Madani

Çështja çame është pika ndarëse tashmë mes PDIU-së dhe qeverisë "Rama". Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi tregon për "Gazeta Shqiptare" arsyet pse ikën nga koalicioni me PS-në dhe iu bashkuan aleancës së kryesuar nga Lulzim Basha. Idrizi thotë se kur mazhoranca mori mandatin, e kishte në program çështjen e gjenocidit çam, por më pas e hoqi, gjë që detyroi prishjen e marrëveshjes dypalëshe. Sipas tij, qëndrimi i qeverisë ndaj çështjes çame dhe ndryshimi total i kursit bën që PDIU të kalojë në opozitë. Me opozitën e dretuar nga Lulzim Basha firmosi në pranë të Presidentit të nderit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, zotin Migliori. Garancia ishte e fortë për Shpëtim Idrizin, saqë nuk e "trikësoi" fakti se në të njëjtin front me të kundërt Ramës është edhe Vangjel Dule i PBDNJ-së. "Unë e di shumë mirë cilët janë pjesëtarët e koalicionit, sepse lexoj edhe gazetat, por marrëveshja është programore dhe jo individuale. Kur ti punon për një marrëveshje programore, nuk mund të bësh negociatat në të pëllqen apo jo një tjetër anëtar i koalicionit. Ajo që më pëlqen është që çështja çame është në programin e opozitës dhe do të jetë në programin e qeverisë së saj", - tha z.Idrizi.



Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi

mirë në masakrën e fundit elektorale, PDIU doli e vetme dhe haptas në program dhe qëllime kundër politikave qeveritare ndaj çështjes kombëtare, ekonomisë dhe zhvillimeve të tjera të natyrës tepsi. Po ju kujtoj që në këto zgjedhje PDIU u votua me mbi 76 mijë vota, 35 për qind më shumë se në vitin 2013, por u masakrua në mandate në Tiranë dhe në Fier dhe nga marrëveshja Rama-Basha për mosformimin e koalicionëve në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Por, për shkeljen e Kodit Zgjedhor, për vjedhjen e mandateve të PDIU, për mospërfaqësimin e mbi 76 mijë votave nuk flet njeri.

**Kjo do të thotë se nuk kemi qeverisur me Edi Ramën?**

Në fakt, nuk kemi qeverisur asnjëherë në qeveri, thjesht bashkëpunonim për reformën administrative dhe padyshim për çështjen çame. A e dini që në mandatin e kaluar kjo mazhorancë e kishte në programin e qeverisë çështjen e gjenocidit çam e sot nuk ka më? E dini besoj që deri dje Rama e Bushati flisnin e bërtisnin për çështjen çame sa na cudisnin edhe ne për këtë "trima" që kishte nxjerrë Shqipëria, e sot thonë që "na falni pak se ashtu ishte loja e ne duhet ta përdornim çështjen çame si çakmak për të nxehur temperaturën me Athinë që të ulemi në tavolinë? E dini be-

"Bushati nuk denjoi as të na takonte më, megjithatë para një viti desh u anëtarësua në shoqatën 'Çamëria' si çam i konvertuar. Po besoj e dini se ndërkohe që Bushati nuk denjoi të na takonte, përgjigjen na e jepte Ciprasi", u shpreh kreu i PDIU.

soj që deri dje Bushati bashkë me ne do e çonim çështjen çame në Bruksel te komisioneri Han, që së bashku me heqjen e ligjit të luftës të ishte një ndër çështjet kryesore të dialogut Athinë-Tiranë. E dini besoj që kur shoqata "Çamëria" e PDIU kërkuan publikisht e zyrtarisht të takoheshin me Bushatin e të informoheshin për ecurinë e bisedimeve, për çështjen çame, të ashtuquajturën marrëveshje e detit etj., Bushati nuk denjoi as të na takonte më, megjithatë para një viti desh u anëtarësua në shoqatën "Çamëria" si çam i kon-

### QEVERISJA

"Në fakt, nuk kemi qenë asnjëherë në qeveri, thjesht bashkëpunonim për reformën administrative dhe padyshim për çështjen çame. A e dini që në mandatin e kaluar kjo mazhorancë e kishte në programin e qeverisë çështjen e gjenocidit çam e sot nuk ka më?", tha z.Idrizi.



Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi dhe kreu i PD-së, Lulzim Basha pas firmosjes së marrëveshjes së përbashkët

in një varr si për çdo njeri që lë këtë botë e do ndëruar nga të gjallët. Mirë për Ciprasin të rënë në luftë pushtuese vlejné e ata të Çamërisë nuk vlejné, por edhe për Ramën e Bushatin nuk vlejné! Kjo e fundit është pika ndarëse, apo bashkuere. Qëndrimi i qeverisë ndaj çështjes çame dhe ndryshimi total i kursit të saj për këtë çështje na nxjerr automatikisht në opozitë.

**Ku konsiston marrëveshja me PD-në dhe a ka bërë të pakënaqur brenda vetë PDIU-së kalimi në opozitë?**

Pikat e marrëveshjes sonë tashmë janë bërë publike, sepse nuk është një marrëveshje kulisash nëtë pa gjumë, por një marrëveshje programore, e cila sheh përtej opozitës. Pa dyshim në qendër të vëmendjes është çështja e gjenocidit çam si prioritet i PDIU-së dhe vlerësimi i prioriteteve programore reciproke. Më duhet të theksoj se me koalicionin me PD-në, ne jemi në një habitat të natyrshëm të spekrtrik politik. Për sa i përket pakënaqësisë, nuk e gjej një gjë të tillë, sepse bashkimin në koalicionin opozitar dhe marrëveshjen e kemi diskutuar në forumet e partisë, sidomos në Kryesinë dhe Këshillin Kombëtar. Pra, nuk është një vullnet i thjeshtë i kryetarit të partisë, por forumeve të saj. Në këtë këndvështrim besoj se kemi përmbledhur aspiratën e anëtarësive dhe votuesve tanë. Por, ne si PDIU nuk harrojmë as armiqtë dhe as miqtë tanë...

**...Dhe tashmë keni zënë miq të rinj. Por në koalicion me PD-në është edhe PBDNJ e Vangjel Dule, a përbën për ju ndonjë problem bashkëpunimi me ta në të njëjtën llogore dhe a keni pasur mundësi që të flisni nga afër për këtë çështje me zotin Basha, apo qoftë edhe me vetë me zotin Dule? Cili ka qenë reagimi i tyre?**

Tani, ne kemi nënshkruar një marrëveshje me Partinë Demokratike, me zotin Lulzim Basha dhe si garant kemi pasur Presidentin e nderit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, zotin Migliori. Ne jemi në një koalicion opozitar, me atë përberje që ka opozita, por marrëveshjen e kemi me kreun e opozitës dhe partinë e tij. Unë e di shumë mirë cilët janë pjesëtarët e koalicionit, sepse lexoj edhe gazetat, por marrëveshja është programore dhe jo individuale. Kur ti punon për një marrëveshje programore, nuk mund të bësh negociatat në të pëllqen apo jo një tjetër anëtar i koalicionit. Ajo që më pëlqen është që çështja çame është në programin e opozitës dhe do të jetë në programin e qeverisë së saj. Besoj se është e qartë që kemi bërë marrëveshje me kryetarin e PD-së dhe mesa di unë, PD ka edhe rreth 30 parti të tjera e gjysmat e tyre nuk i njoh. Ju mos prisni që unë t'i them Bashës fjala vjen ndonjë fjalë për Nard Ndokën, megjithëse edhe ky ka ankesa. Ne jemi politikanë që funksionojmë në bazë programesh, jo sentimentesh individuale.

**Cila është përgjigja juaj për ata që PDIU-në e quajnë si parti klienteliste...?**

Nuk kam asnjë përgjigje për njerëz punëkotë që merren me thashetheme. Ne nuk kemi qenë kurrë në pushtet, nuk kemi pasur asnjëherë 1 ministër dhe qenkemi "klienteliste"? Na kanë vjedhur votat, na kanë djegur mandatin dhe qenkemi "klienteliste"? As 1 për qind të pushtetit nuk ka ushtruar PDIU dhe qenka "klienteliste"? Ne kërkojmë hapjen e dosjeve për politikanët dhe qenkemi "klienteliste"? Ne kërkojmë bashkimin kombëtar dhe qenkemi "klienteliste"?!

**Atëherë përse ju quajnë të tillë...?**

Po, unë e di përse e bëjnë, kanë një agjendë denigruese,





## ## PËR VANGJEL DULEN

"Une e di shumë mirë cilët janë pjesëtarët e koalicionit, sepse lexoj edhe gazetata, por marrëveshja është programore dhe jo individuale. Kur ti punon për një marrëveshje programore, nuk mund të bësh negociatat në të pëlqen apo jo një tjetër anëtar i koalicionit. Ajo që më pëlqen është që çështja çame është në programin e opozitës dhe do të jetë në programin e qeverisë së saj", - tha z.Idrizi.

e cila nuk ka për shënjestër vetëm një parti politike, por një komunitet të caktuar, atë të çamëve. Është e njëjta metodologji denigrimi, raciste, separatiste që përdorte dikur Enver Hoxha që po përdorin këta sot. Në rastin më të mirë kemi të bëjmë me gjobaxhinj mediatikë, të cilëve nuk u janë paguar më tryezat e tavave të peshkut. Në rastin më të keq antishqiptarë që marrin para në Athinë.

**Si e shikoni opozitën nën drejtimin e Lulzim Bashës? Çfarë duhet të përmirësojë ajo që të "mundë" Edi Ramën?**

Me një fjalë, do ta përmbledhja me togfjalëshin opozitë denoncuese. Ka bërë mirë nxjerrjen në dritë të skandaleve dhe problemeve të mëdha që po e firojnë përditë këtë vend e që nis nga supremacia e kurajës në vend, që krimi ka marrë e sigurisht problematikat e thella ekonomike. Shoh një opozitë më të motivuar, e cila po punon për të rritur besueshmërinë dhe që nuk fsheh gabimet e së shkuarës së afërt. Kjo është padyshim shenjë e pjekjes së opozitës dhe e kryetarit të saj. Por sigurisht që kjo nuk mjafton. Që opozita të ngjallë shpresë do duhet që të sjellë një program ekonomik e social që do drejtojë ekonominë nga prodhimi e do ndihmojë shtresat në

nevojë. Opozita duhet të ketë një program të qartë se si do e mundë krimin e korrupsionin galopant që po shkatërojnë çdo iniciativë biznesi e rritje ekonomike. Është urgjente që opozita së bashku të fillojë një organizim në terren e shtrirje në mënyrë kapilare të evidentimit e përfshirjes së mbështetësve, simpatizantëve e personave të tjerë që janë prekur nga qeverisja problematike e sotme. Bashkimi i të tre këtyre komponentëve na krijon të gjitha kushtet që të hyjmë në zgjedhje e të kthejmë nga pozitiviteti e ndryshimi rrënjësor këtë vend.

**Cila ofertë i duhet opozitës së bashkuar kundër qeverisë "Rama"?**

Një dhe vetëm një, shpresa. Nëse ua ngjall qytetarëve shpresën, atëherë rrëzimi i qeverisë është i mbaruar. Duhet t'u kthejmë njerëzve shpresën që me largimin e Rilindjes, vjen zhvillimi, rregullat e lojës dhe jo një tjetër grup kriminal në pushtet. Shpresa nuk i detyron shqiptarët të marrin kurbetin, sepse askush nuk ikën me dëshirë nga vendi i tij. Këta po i përzënë, sepse kanë "vrarë" shpresën. Ne duhet ta kthejmë atë që të dalim para njerëzve ballëhapur. Ka vetëm një ofertë që opozita do sjellë në këtë vend, ndryshimi i gjendjes më shumë se të vështirë që po kalon vendi

"Në një koalicion me Dulen? Edhe Ndoka ka ankesa ndaj nesh, por firmosa me PD-në"

# Marrëveshja me Bashën, Idrizi: Tri rrugët e opozitës drejt pushtetit

"Parti klienteliste? PDIU kurrë nuk pati një ministër"

e kthimi në normalitet. Kjo opozitë sot është realisht mazhorancë numerike. Ne kemi të gjitha numrat për të qenë forcë drejtuese e vendit, por kjo nuk mjafton. Do u sjellim shqiptarëve mentalitet të ri në qeverisje e alternativën se si të kemi një vend normal. Të kemi një ekonomi që prodhon, të kemi një program se si shqiptarët të punojnë në vendin e tyre, të paguhen denjësisht, të shkollohen e të begatohen në shtëpitë e tyre. Do duhet të sjellim një program reformator të një mazhorance reale, atë që për fat të keq për shqiptarët nuk e bëri dot asnjë ditë kjo qeveri. Ka ende shumë për të bërë që njerëzit ta besojnë plotësisht këtë opozitë dhe ta shohin si alternativa e vetme ndaj qeverisjes aktuale. Po e arritëm këtë, pushteti i Rilindjes bie shumë shpejt.

**Sipas jush, kush tjetër duhet t'i bashkëngjitet frontit të djathtë që të fitojë zgjedhjet e ardhshme vendore?**

Gjithkush që kërkon ndryshimin. Nuk ka rëndësi në është i majtë apo i djathtë. Rëndësi ka nëse do të jetojë në një vend të paqte dhe me rregulla, ku shteti nuk kapet peng nga "të fortët". Gjithsecili është i vlefshëm në këtë front që nga bujku i thjeshtë deri tek shoqëria civile apo partitë e tjera politike. Kjo do të arrihet kur të shkojmë së bashku në zgjedhje për ndryshimin e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Shqiptarët kanë kuptuar që kanë përballë një mazhorancë joreale e që ka tjetërsuar vullnetin e shqiptarëve e sot po keqpërdor pushtetin. Oferta jonë duhet të jetë e qartë, njerëzit duhet të dinë për kë e për çfarë do duhet të votojnë e jo për tepsia e kusia.

**Çfarë garancie keni marrë nga kreu i opozitës Lulzim Basha për zgjedhjen e çështjes çame?**

Nuk ka garanci të fshehura e marrëveshje kulisash. Kemi një marrëveshje të nënshkruar nga unë, Basha dhe i nderuari Ricardo Migliori. Tani kemi një dokument detyrues për të gjithë ne. Nuk na shkoj kurrë mendja të linim litarin jashtë, kur punonim për draftin që u kthehe në marrëveshje. Nëse nuk beson në rregullat që përcaktojnë një koalicion opozitar, si mund të



"Sa njomën buzët me gotën e parë të uzos, heshitën me shqiptarët. Por, nisën të bëhen fjalamanë dhe të papërmbytur me grekët. Në informacionet që unë kam, kanë sajuar një hartë që po i merr det e toka Shqipërisë, por ne nuk do i lejojmë", tha kreu i PDIU.

shpresojmë në rregullat e një koalicioni në pushtet nesër? Prandaj PDIU dhe PD kanë një marrëveshje, si e vetmja garanci në këtë rrugëtim të vështirë, por që kam bindjen që përfundon me fitoren e sigurt.

**Cila ka qenë përgjigja e kryeministrit Rama për deklaratën e presidentit grek se çamët kishin sjelljen e sundesit dhe bashkëpunonin nazistët?**

Heshitja. Sa njomën buzët me gotën e parë të uzos heshitën me shqiptarët. Por, nisën të bëhen fjalamanë dhe të papërmbytur me grekët. Në informacionet që unë kam, kanë sajuar një hartë që po i merr det e toka Shqipërisë. Por, ne nuk do i lejojmë. Ata ndoshta nuk e dinë që Homeri e ka thurur Odisenë në ato toka, se atje ka lindur, tek

Orakulli i Dodonës. Prandaj, pëlhurën e Penelopës, ne çamët e dimë shumë mirë si thuret, por edhe si shtihuret.

**Pas bashkimit me PS-në, ju keni deklaruar se "Për herë të parë një kryeministër artikuloi për çështjen çame". Çfarë ndodhi më pas...?**

Për këtë duhet pyetur Edi Rama. Ne nuk ia përmbysem gotën siç bëri ai. Por, ai vetë e ka thënë se e përdori çështjen çame që të ulte grekët në tryezë. E përdori si kokëdash për të hapur dyert e Athinës. Sa u ul me ta e hodhi pas kraheve retorikën e deridjeshme.

**A jeni gati t'i kërkonte fjalë publike Edi Ramës nëse në bisedimet me Greqinë ata e kanë zgjidhur çështjen çame...?**

Jo vetëm Ramës, por edhe gjithë rilindasve një nga një. Por, të jeni e bindur kanë bërë një vrimë në ujë, të cilën do të përpiqen ta shesin si fitore. Këtyre u janë zhveshur të gjitha lëkurët. U ka mbetur vetëm cipa e propagandës.

**A morët një përgjigje nga kryeministri Rama për deklaratën e presidentit grek se çamët kishin sjelljen e sundesit dhe bashkëpunonin nazistët?**

Sigurisht që deklaratave arrogante të Presidentit të Greqisë, Pavlopoulos, duhet t'i përgjigje kryeministri, presidenti e ministri i Jashtëm. Unë e kuptoj pse ju e kërkonte nga Rama. Por ka kohë që Ramës, që sokëllinte fort për çështjen çame në parlament i ka ikrur

**KRIKTIKA**  
"Deri dje Rama e Bushati flisnin e bërtisnin për çështjen çame sa na çuditnin edhe ne për këta 'trima' që kishte nxjerrë Shqipëria, e sot thonë që 'na falni pak, se ashtu ishte loja e ne duhet ta përdornim çështjen çame si çakmak për të nxehur temperaturën me Athinën që të ulemi në tavolinë"

zëri në raport me Greqinë, e tashmë hesht si "fija e barit". Por, ka ardhur koha që t'i japim fund kësaj maskarade, ku shteti grek që mendon se i ka duart më të forta, i ndihmuar nga idiotët e dobishëm të Tiranës, të mund të përmbyset pa asnjë argument, pa asnjë fakt të vërtetë e madhe të masakrimit të mijëra shqiptarëve të Çamërisë, pleq kra e fëmijë, të vrarë në shtëpitë e tyre e jo në luftë. Përballë i mijë partizanëve çamë të inkuadruar në dy anët e kufirit në batalionin 'Ali Demi' në Çamëri dhe të batalionit 'Çamëria' në Konispol, Greqia nuk paraqet një fakt, një foto, një formacion çam, apo cilat ishin krimet e çamëve në shtëpitë e tyre. Pse Greqia në 74 vjet nuk ka kërkuar kurrë nga Shqipëria që të ekstradohet në Greqi, qoftë edhe një çam i vetëm që ka bashkëpunuar apo ka bërë krime? Prandaj ne i kemi kërkuar publikisht shtetit shqiptar që të kërkojë hapjen e debatit publik me historianët, për atë që ka ndodhur në Çamëri. Boll më reitorikën e një presidenti, që edhe për vetë moshën duhet të ishte i kujdesshëm kur shkoj pikërisht në Paramithi, ku filluan masakrat më 27 qershor 1944 e ku u masakruan 680 shqiptarë të Çamërisë. Ne nuk kemi bërë përgjegjës popullin grek apo qeverinë e sotme greke, por është e rëndë për vetë popullin grek, që Presidenti i Greqisë vetëdeklarohet si pasardhës i kriminelit Napoleon Zerva. Ta harrojë Pavlopoulos dhe idiotët e dobishëm të Tiranës që rruga e Shqipërisë për në BE kalon nga Athina.

Drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave, në "News 24"

# Niko Lera: Qeveria do u vërë drynin edhe basteve "online"

## Mbetet Lotaria Kombëtare, Telebingo dhe kazinotë elektronike në hotele me 5 yje

I ftuar në emisionin "Kjo Javë", në "News 24", Niko Lera, drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave, sqaroi projektligjin e propozuar nga kryeministri Edi Rama për lojërat e fatit, ndryshimet në të cilin këtë herë kanë përfshirë edhe bastet sportive. Në një konferencë për mediat, ku njoftoi vendimet e qeverisë, Rama bëri të ditur ndryshimet në këtë ligj, ndërsa u shpreh se nga 1 janari i vitit të ardhshëm, asnjë qepen lokal që ka në të baste sportive apo kazino, nuk do të ngrihet. Fillimisht Lera sqaroi nismën e ndërmarrë në vitin 2013, për të cilën tha se kishte për synim kufizimin e tyre, reduktimin e informalletit dhe kontrollin e këtyre subjekteve.

"Në 2013 u organizua aksioni për mbylljen e lojërave të fatit të palicencuara. U sulmuan ato lojëra fati që ishin informale. Një pjesë u mbyllën, ndërsa pjesa tjetër që donin të ushtronin konform ligjit u formalizuan. Ajo që ndodhi në 2013-ën ishte formalizimi i lojërave të fatit. Strategjia e ndjekur në këto vite ka qenë kontrolli dhe kufizimi i tyre", u shpreh Lera. "Nga 2013-ën synimi ishte zbatimi riguroz i ligjit. Me të drejtë mund të thonë pse numri i operatorëve u zvogëlua dhe u rrit numri i njësive apo i vendeve sekondare, por nëse shteti synon të formalizojë kompanitë, nuk mund të kufizojë një kompani informale të zgjerorë veprimtarinë e vet. Ndaj, kompanitë rritën numrin e pikave të basteve", - vijoi ndër të tjera drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave, ndërsa theksoi se ky zgjerim i këtij biznesi krijoi probleme të tjera sociale, ndaj edhe del prioritar problemi social. "Edhe bastet 'online' do të jenë pjesë e kësaj mase, pra nuk do të luhet as 'online'. Shteti, administrata që do të



lançojë një masë të tillë, ka edhe detyrimin ligjor të kontrollorë zbatimin e kësaj mase. Pra, organet ligjzbatuese të këtij vendi, tatimet apo policia do të jenë në funksion të zbatimit të këtij ligji", deklaroi drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave.

### EFEKTET FINANCIARE

Duke u ndalur te efektet financiare që sjell mbyllja e kësaj industrie në vend, Lera tha se formalizimi i tyre rriti të ardhurat në buxhetin e shtetit dhe me vendimin e fundit do të kemi një rikompozim të lojërave të fatit. "Ne kemi llogaritur një efekt diku të 70-75% të të ardhurave që mbledhim nga lojërat e

fatit, por kemi parashikuar edhe burimet që do të zëvendësojnë të ardhurat që ne do të humbasim", tha Lera. "Do të mbeten në tregun e lojërave të fatit, me këto dy ndryshime që janë deklaruar deri tani, Lotaria Kombëtare, Bingo Televizive dhe lojërat elektronike në struktura akomoduese të licencuara me 5 yje që kanë kazino, apo në resortet turistike. Sepse ka mundësi kontrolli të plotë", deklaroi Lera. Duke u ndalur në efektet sociale që do të sjellë ky ligj, Lera sqaroi se janë rreth 4200 vende sekondare biznesi të këtyre tri kompanive, që zhvillojnë aktivitetet e bastet sportive. "Një pjesë e madhe e tyre nuk janë ek-

skluzivisht pika bastesh, por janë edhe 'bar bufe', ku ka një vend të veçantë ku vendosen baste. Ne në të gjithë tregun e lojërave të fatit kemi 7280 të punësuar, një pjesë e tyre do të vazhdojnë të jenë të punësuar, sepse janë punësuar në Lotarinë Kombëtare, në BINGO Televizive etj. Kemi llogaritur me logjikën e të ardhurave që 65-70% e këtij numri i përket kësaj kategorie të lojërave të fatit, që nuk do të jetë më në treg. Nuk do të mbetet asnjë njeri pa punë, sepse janë 4200 pika bastesh, por njëkohësisht janë edhe bar bufe, ai është i licencuar si bar bufe, pra nxjerr të ardhura. Në 4200 pika, pjesa kryesore

**PROPOZIMI PER MONOPOL SHTETOROR**  
Në përfundim, Lera theksoi edhe një herë se një mënyrë e organizimit mund të jetë organizimi nëpërmjet një monopoli shtetëror, një opsion tjetër mund të jetë organizimi përmes një kontrolli të rreptë të pagesës, apo futjes në lojë përmes kartës së identitetit të çdo personi, nëse është në moshën e lejuar.

**basteve: Sjell konsekuenca në shoqërinë shqiptare**  
Drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave, Niko Lera komentoi në emisionin "Kjo Javë" në "News 24", edhe deklaratat e deputetit Erion Braçe në parlament, i cili foli për shtetëzim të lojërave të fatit. Lera tha se nuk duhet përdorur termi "shtetëzim", pasi shteti nuk po konfiskon pasurinë e dikujt dhe ta përdorë për interesat e veta. "Po mbyllet një biznes i caktuar, sepse konsekuencat që sjell në shoqërinë shqiptare janë gjykuar që janë me pasojë. Në kuptim të prishjes së familjeve, shpenzimit të lekëve në mënyrë joproduktive, të futjes së kapitaleve me origjinë të dyshimtë etj., pra këto janë faktorët kryesorë që imponuan këto zgjidhje", theksoi Lera.

kanë aktivitetet kryesore lokal, por edhe ato që janë thjesht pika bastesh, do të rristrukturohen", tha Lera.  
Referuar deklaratës së ministrit Ahmetaj në parlament se do të ketë një program rikualifikimi për ata që do të mbeten të papunë, Lera tha se jemi në një proces riformatimi të të gjithë sektorit, që përfshin jo vetëm lojërat e fatit, ndërsa garantoi se nuk ka për të ngelur asnjë dyqan, asnjë pikë bastesh i mbyllur, ato do të kthehen në biznese të tjera në shërbim të konsumatorit.

**SHPJEGIMI**  
**Arsyet e mbylljes së**



Prokuroria përgatitet të mbyllë hetimet për ish-ministrin e Brendshëm për grup kriminal

# Tahiri para gjyqit, gati dosja e akuzës

## Ish-funksionari i PS dyshohet se favorizoi kushërinjtë trafikantë

**P**rokuroria e Krimeve të Rënda pritet më në fund të vendosë mbi fatin e procedimit penal të nisur ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahirit, i cili akuzohet për trafik narkotikësh në kuadër të grupit të Habilajve, që u godit në Itali. Ditën e hënë përfundon afati i hetimit, pas dy shtyrjesh dhe prokuroria pritet të dalë me një vendim, nëse do ta dërgojë për gjykim ish-ministrin Tahiri, apo do të pushojë çështjen ndaj tij. Burime të "Top Channel" pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda kanë pohuar se grupi i hetimit të kësaj çështjeje pritet të kërkojë dërgimin për gjykim të Tahirit. Kjo kërkesë pritet t'i bëhet Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe do të jetë kjo e fundit që do të vendosë mbi fatin e dosjes. Nga hetimet e kryera, ish-ministri Tahiri dyshohet se i ka krijuar lehtësira grupit të Habilajve, për kultivimin dhe më pas trafikimin e kanabisit drejt Italisë. Këto dyshime, Prokuroria e Krimeve të Rënda i ka ngritur pasi në më shumë se një rast eksponentë të grupit kriminal kanë përdorur mjete motorike dhe detare në emër të ish-ministrit Tahiri. Për këtë, prokuroria ka marrë edhe disa letërporsori nga Greqia, Mali i zi dhe Italia.

Në të njëjtën dosje me ish-ministrin Tahiri është edhe ish-financieri i grupit të Habilajve, Nezar Seiti, i cili në rrugë ekstraprocedurale u ekstradua në Itali, por që më pas autoritetet italiane e liruan dhe aktualisht ai është në pritje të gjyqimit nën masën e sigurisë arrest shtëpie.

### IRONIA E DRITAN ZAGANI

Debati i fundit që po zhvillohet rreth çështjes "Babale" pas publikimit të videos së dytë nga ana e deputetit të PD-së, Ervin Salianji, ku flitet edhe për qindra mijëra euro që palët do të paguanin që ta kishin "në anën e tyre" Fredi Alizotin, nuk i ka shpëtuar pa komentuar dhe Dritan Zaganin. Ish-oficeri i Antidrogës përmes një postimi në rrjetet sociale ka ironizuar situatën, duke shkruar se edhe atij i ka lindur një ide



### DRITAN ZAGANI

Ish-oficeri i Antidrogës, Dritan Zagan përmes një postimi në rrjetet sociale ka ironizuar situatën, duke shkruar se edhe atij i ka lindur një ide për të bërë para. Zagan pohon se kërkon 200 mijë euro për të përgjeshtruar veten e tij dhe akuzat për Saimir Tahirin.

për të bërë para. Duke iu referuar akuzave të qeverisë ndaj tij se ai ishte i paguar kur artikuloi publikisht akuzat për Saimir

Tahirin si i implikuar në trafikun e drogës me Habilajt, Zagan tani ka një pyetje dhe një kërkesë.

### POSTIMI I PLOTË

Duke parë e dëgjuar nga të gjitha anët situatën e sotme në vendin tim lidhur me pagesat që përfliten për

çdo video që qarkullon, më lindi një ide të bëj naj lek se po më kalon jeta pa lekë fare...! Meqë pretendimet e Ril-

indjes se jam paguar mirë nga PD për gjithë sa kam bërë e thënë deri më sot për mua është shpifje, dhe për faktin se as tokën në fjalë s'e kam, le pastaj lekë apo euro, si dhe duke marrë shkas nga këto pagesat e majme që dolën këto dite për videot "Babale", unë kam një pyetje (kërkesë) për ta...!

"Sa është pagesa po të bëj një video, ku të përgjeshetroj veten dhe të akuzoj kundërshtarët se më kanë paguar ata që të flas keq (pra të shpif) për Rilindjen, Sajen dhe lidhjet e tyre me trafikun e drogës në këto 5 vjet Rilindje".

Video e bëj dhe tekstin le ta shkruajë Taotao, ose edhe vetë Fugsi i vogël, për mua s'ka problem, por sqaroj se nuk marr dot përsipër të përgjeshetroj antiamfian dhe shtetin italian lidhur me çështjen...!

P.s. unë s'dua 200 mijë euro, kënaqem me gjysmat.

## Prokuroria: Ja roli i Jaeld Çelës, Sokol Bodes dhe Gjergji Kohilës

### "Gjysma" e policisë së Vlorës në kërkim, si e favorizuan trafikun e hashashit drejt Italisë

#### SHEFI I POLICISE SE DHERMIUT

"Pjesëmarrës në këtë grup kriminal është edhe shtetasi Sokol Bode, me detyrë shef i Stacionit të Policisë Dhërmi, i cili ka mbajtur lidhje duke i ofruar ndihmë dhe mbështetje anëtarëve të këtij grupi kriminal, me qëllim realizimin e trafikimit të narkotikëve nga Shqipëria drejt Italisë", thuhet në dosjen hetimore.

Habilaj për të kryer trafikimin e lëndëve narkotike u dyshua nisur nga shtrirja e aktivitetit kriminal në kohë dhe hapësirë, sasitë e lëndëve narkotike të sekuestruara në Itali dhe në Shqipëri, sendet e sekuestruara tek banesa e shtetasit Armand Koçerri dhe tek objekti në pronësi të shtetasit Florian Habilaj, të dhënat nga bisedat telefonike mes shtetasve Moisi Habilaj, Florian Habilaj, Nezar Seiti dhe personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtarë kriminale. "Nga hetimet e kryera rezultojn se pjesëmarrës të këtij grupi kriminal janë dhe shtetasit

Sokol Bode, me detyrë shef i Stacionit të Policisë Dhërmi, i cili ka mbajtur lidhje duke i ofruar ndihmë dhe mbështetje anëtarëve të këtij grupi kriminal me qëllim realizimin e trafikimit të narkotikëve nga Shqipëria drejt Italisë", thuhet në dosjen hetimore.

Nga ana tjetër, një rol aktiv shihet në dosje rezultojn të ketë pasur edhe shefi i Hetimit të Narkotikëve dhe Trafiqeve, Gjergji Kohila, i cili thuhet të ketë bashkëpunuar drejtpërdrejt me trafikantët. "Po ashtu rezultojn se ka dyshime për faktin se shtetasi Gjergji Kohila, me detyrë shef

sektori për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë ka mbështetur dhe ka bashkëpunuar me anëtarët e këtij grupi kriminal në kultivimin e bimëve narkotike dhe më pas trafikimin e saj", - sqarohet në dosje. Më tej në dosje përmendet drejtori i Drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë, Jaeld Çela, i cili dyshohet se bashkëpunonte me anëtarët të grupeve kriminale për kultivimin e bimëve narkotike dhe më pas trafikimin e saj. "Nga hetimet e kryera rezultojn se shtetasi Jaeld Çela, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë, është bashkëpunim me punonjësit e policisë Gjergji Kohila, Sokol Bode dhe punonjës policie të tjerë kanë mbështetur, garantuar e bashkëpunuar me anëtarët të grupeve kriminale për kultivimin e bimëve narkotike, më pas trafikimin e saj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", thuhet në dosjen e

### prokurorisë. ISH-ZYRTARËT

Prokuroria e Krimeve të rënda në vijim të hetimeve për dosjen "Habilaj" ka shpallur në kërkim tre ish-zyrtarët e Policisë së Vlorës. Konkretisht ish-drejtorin e Policisë së Vlorës, Jaeld Çela; shefin e sektorit të luftës kundër kriminit të organizuar në Drejtorinë e Qarkut Vlorës, Gjergji Kohila si dhe ish-drejtorin e Postës së Dhërmit, Sokol Bode. Masa e ndalimit ndaj tre ish-zyrtarëve është dhënë pasi akuzohen për mosveprim ndaj kultivimit të kanabis nativ në këtë qark, duke lejuar trafikimin e drogës së Habilajve në drejtim të Italisë. Urdhër-arrestet e lëshuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda i janë dërguar për ekzekutim Policisë së Shtetit. Por, policia ngriti dyshime se operacioni është dekonspiruar. Kjo për faktin se nuk është kryer ende asnjë arrestim, pasi asnjë nga ish-zyrtarët nuk është gjetur. Ministria e Brendshme reagoi duke sqaruar se pavarësisht kontroleve të ushtruara në banesat dhe vende ku dyshohet se mund të strehoheshin ish-zyrtarët Çela, Bode dhe Kohila, nuk është bërë e mundur gjetja dhe ndalimi i tyre. Ndaj tyre u mor vendimi për përjashtim nga radhët e Policisë së Shtetit.

**NOJFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFLUQ 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSITË Z. PËRLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.

ÇMIMI 3.850.000 LEKË. -Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866.

**EPSA** SHOQËRIA PERMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NOJFTIM SHPALLJEN E ANKANDIT PER :

1- "Ndërtues 3 Kat", pa truall, me valem Kati i Pare i regjistruar ne ZVRPP Tirane me sip. 131 m<sup>2</sup> dhe Kati i Dytë dhe Kati i Tretë ndertim pa leje", i ndodhur ne Rr "Siri Kodra", Tirane, Zona Kadastrale: 8340, Numri i Pasurisë: 4/171-ND, Vol.9, Faqe 127. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te **Fethi Kaya**. Çmimi te cilin fillon ankandi eshte **12.320.000 Leke**. Ankandi zhvillohet date **23.10.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne [www.epsa.al](http://www.epsa.al)

**3H** SHOQËRIA PERMBARIMORE GJYQESORE "3H" Sh.p.k

Rr. "Tish Dahi", Kompleksi Kila 2, Kulla 5, Kt. 1, Tirane  
Web: www.3h.al, Email: shpg\_3h@yahoo.com/062809711

Nojfton shpalljen e ankandit nga **dt.11.10.2018 deri ne dt. 19.10.2018** per: sendin e luajtshem mjeti me targe AA 089 OB ne pronesi te Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M

Cmimi fillestar eshte 993 EURO

Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten **19.10.2018** dhe mbyllet me orarin zyrtar **16.00**.

KURATORI

# Nadarët dhe Marubët, ngjashmëria e dy botëve në fotografi

Fatmira Nikolli

Ju do të zbuloni botën e spektaklit parisien. Paul Nadar ishte i dashuruar me një aktor, gjë që nuk i pëlqente të atit (themeluesit të studios Felix Nadar), por Paul është në fakt fotografi i parë që doli nga studioja e tij dhe shkoi drejt botës së artit. Kjo është një ekspozitë estetike dhe historike, por mbi të gjitha është një ekspozitë me arki-va". Mbrëmjen kur në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi" në Shkodër u çel ekspozita "Nadar mes rregullave dhe tekave", kuratori Michel Poivert foli pak për fotografët francezë, Felix e Paul Nadar. Më tej, ai mbajti të nesërmen në "Marub" një bisedë mbi atelierin Nadar, duke u përqendruar tek evolimi i traditës së portretit nga ai klasik i Felix Nadar, tek pozat e stisura të të birit Paul, i cili fotografon jashtë studios, në teatrot dhe skenat e kohës, duke u përshtatur ndryshimit të mentalitetit, mes romantizmit dhe modernes. Kjo bisedë kërkoi të ndërtojë një krahasim mes veprës së Paul Nadar dhe asaj të të atit Felix: si evoluon tradita e portretit romantik nga shekulli XIX në shekullin XX? Si i rishpik Paul kodet e famës, duke inauguruar edhe traditën e portretit të artistëve jashtë studios? Qasja e bisedës kërkonte të përcillte se si Nadari i ri u përshtat ndryshimit të kohërave dhe mentalitetit, mes romantizmit dhe modernes. Nga e gjithë biseda, duke pasur në vëmendje edhe bashkëkohësinë mes Nadarve dhe Marubëve, mund të gjesh linja krahasimi: të dyja atelierët kanë fokusuar emrat më në zë të kohës së tyre, nga emrat e artit të familjet e mëdha, të dy atelierët kanë dokumentuar botën që ndryshonte para syve të tyre; të dy atelierët i kanë "retushuar" fotografitë për të përcjellë me to imazhet e mesazhet që për ta qenë me rëndësi. Retushimi i kohës në ditët tona mund të kuptohet si fotoshop. Trashëgimia që kanë lënë pas dy studiut, edhe pse në dy realitete të ndryshme, kilometra larg, në dy botë



## Michel Poivert shpjegon imazhet e Francës në vitet 1900

kaq larg, ku dasia ka të bëjë edhe me kulturën dhe ndikimet e dasitë mes orientit e oksidentit, gjen sërish pikëtakime që e bëjnë këtë ekspozitë në "Marub" edhe më të nevojshme se ç'mund të kuptohet në pamje të parë. Imazhet e civilëve, kompozimi, portretet e kërkuara e të përzgjedhura për t'u fiksuar e për t'u përcjellë në motmote, anipse në dy botë disi larg, rreken të na sjellin kaq pranë ngjashmëritë përtej dasive dhe na bën të kuptojmë se që një kohë, kur ne mundëm të ishim të njëkohshëm me perëndimin e mundëm njëfarësoj të jemi në një hap me ta, në fotografi.


### BISEDA

Michel Poivert e nis bisedën duke nxjerrë në pah se Nadarët kanë fotografuar kërcimtare të njohura të kohës, njerëz të veshur me kostume. Ai përqendrohet më shumë tek biri se sa tek ati kur thotë se, "ai u kërkoi personazheve të luajnë para aparatit fotografik dhe studioja fotografike kthehet në një skenë teatri". Vë në dukje po ashtu se është një shpikje e Nadar, që e koncepton studion si një hapësirë ku mund të bëhet teatër, ku mund të ketë skena duke rindërtuar skenat teatrale aty. Nadar i ri, pasi thyen rregullat e estetikës së kthjelltësisë së të atit, realizon një sërë portretesh me shumë artificie, siç janë ata të aktorëve në skenat e teatrit. "Paul Nadar bën një fotografi për të cilat krijon edhe sfonde. Edhe në fondin e "Marubit"

shihet edhe inkuadrimi apo kuadrati i fotografive. Duke parë gjithë sfondin e fotografisë, mund të thuhet se fotoja është një ndërtim. Shpeshherë krijohet

Vihet re se një element i rëndësishëm i fotografisë është në këtë kohë edhe retushimi, ku ka retushim profesional, thënë ndryshe një lloj fotoshopimi i sotëm, që personazhet e fotografuara të dukeshin më bukur. "Retushimi ishte element i rëndësishëm, sepse kishte ripikturim elementësh.

hen skena që tërhiqet vëmendja. Mund të bëhen krahasime mes babait e birit, Felix e Paul ku i biri e transformon studion në një skenë teatri. Ka edhe skena qesharake, kur artisti është i përqendruar në punë dhe krah tij del edhe asistenti", tha Poivert. Për të, në imazhet e sjella ka një takim të fotografisë, teatrit dhe kulturës. Vihet re se një element i rëndësishëm i fo-



tografisë është në këtë kohë edhe retushimi, ku ka retushim profesional, thënë ndryshe një lloj fotoshopimi i sotëm, që personazhet e fotografuara të dukeshin më bukur. "Retushimi ishte element i rëndësishëm, sepse kishte ripikturim elementësh. Vihet re në ekspozitë për shembull se si duket Sarah Bernard para dhe pas retushit". Poivert sqaron se në fund të shekullit të 19-të, në Paris njerëzit e famshëm nuk ishin më shkrimtarët, por aktorët dhe Paul Nadar e kuptoi që publiku donte fotografi të njerëzve të teatrit. "Studio e Nadar kthehet në skenë teatri, ku aktorët riluajnë pjesët e tyre para aparatit", thotë ai. Mandej, Nadar nis të shkojë në teatër me aparat për të kapur çastet e interpretimit, mimikat e

skenat ndaj dekorit është ai i teatrit. "Ai tregonte dy anët e jetës në atë kohë, jetën e spektaklit dhe jetën jashtë tij. Vjen një moment që bëhet vështirë të dallohet cili është personazhi aktor e cili është ai civil, njeri i thjeshtë. Të gjithë shfaqen me kostume. Kostumet kishin një vlerë të veçantë në ceremonitë zyrtare, për studiot fotografike dhe për teatrin. Ndonjëherë ka diçka komike të personazhet, ka një bashkim të reales me imagjinatën në fotografitë e Nadar. Ai ka arritur të përcjellë edhe ndjeshmërinë në imazhe, qoftë kur ka fotografuar fëmijë, qoftë kur ka fotografuar dy të dashuruar", thotë kuratori i ekspozitës gjatë bisedës. Pas daljes nga studio për në teatër, ai del nga studio, edhe për të fiksuar me aparat Francën e kohës. "Nis të fotografojë monumentet, largohet nga studiot e personazhet, merr aparatin në dorë e del të fotografojë historinë. Fotografon stacionet e trenit, gjithë industrinë e transportit që sapo kishte filluar, ndërtimet industriale, monumentet që janë në shkatërrim dhe arrin të fotografojë edhe lëvizjet e personazheve. Nga fotografitë fikse të njerëzve që pozonin për të, ai kalon në fiksimin e imazheve në lëvizje", vëren kuratori. Fotografitë tanimë sjellin popullsinë e thjeshtë në përditshmërinë vet. Kuratori vëren se imazhet me gjithë kohën kur u shkrepen, janë bashkëkohore dhe kemi pothuaj një estetikë industriale. "Janë disa fotografi e ndërtesa që më vonë shkatërrohen, ndaj kanë vlerë të madhe sot, sepse kanë dokumentuar historinë", thotë ai.



E DIEL

14 Tetor

2018



## IN MEMORIAM

# Fatos Arapi (1930-2018)

me jetën dhe madje edhe duke kërkuar ndjesë për prodhimin e para viteve '90, paçka se në krijimet e asaj kohe gjenden shumë nga poezitë e tij më të mira.

Fatos Arapi ishte i lindur në vitin 1929 në Vlorë, ku qëndroi deri për arsimimin e mesëm, ndërsa studimet e larta i përfundoi në Bullgari (Sofje) në fakultetin e Matematikës dhe të Ekonomisë. Duhet vlerësuar se për shumë vjet ishte gazetar dhe pedagog, ndërsa Fakultetin Histori Filologji të Tiranës. Me emrin e tij janë të lidhura shumë çmime kombëtare e ndërkombëtare për poezi. Kulmin e arriti në vitin 2008, kur meritoi "Kurorën e artë" në aktivitetin e madh poetik "Mbrëmjet e poezisë strugane", një çmim që deri më atëherë s' i ishte dhënë asnjë poeti shqiptar.

Në vitin 2014 u përmbloodh e gjithë krijimtaria e tij ndër vite në katër vëllime : "Më jepni një emër : poezi të zgjedhura 1962-1989"; "Në kaq pak Tiranë : poezi të zgjedhura 1990-1996"; "Urna e vogël : poezi të zgjedhura 1997-2003" dhe "Një buzëqeshje e pabesueshme : poezi të zgjedhura 2005-2010". (b.an)

Pak ditë më parë ndërroi jetë poeti i njohur shqiptar Fatos Arapi. Është nga të pakët shkrimtarë shqiptarë, që pati fatin e madh të ndjente prej së gjalli se ishte pjesë organike e klasikëve të njohur shqiptarë. Ndaj, askush nuk u habit që Parlamenti shqiptar mbajti një minutë heshtje për të, kurse Biblioteka Kombëtare, çeli menjëherë një ekspozitë me veprat e tij.

Për shumë vite kishte heshtur dhe zgjedhja e tij ishte respektuar nga komuniteti i njerëzve të artit dhe jo vetëm. Duke e parandjerë ndoshta limitin e jetës, por edhe krizën e madhe morale të vendit, ai i ishte përshfaqur publikut vetëm përmes veprës së vet. Por, jo përmes komunikimit. Refuzonte për këdo...

Fatos Arapi mbetet një nga poetët më të vyer të gjuhës sonë, me një lirizëm të këndshëm, që mund të lexohet edhe për shumë fasha shoqërore. Nuk shqetësohej shumë për atë që mund të thoshin dhe të kumtonin të tjerët, sepse e quante misionin e vet të përfunduar në letërsi. Duhet thënë se vepra e Fatos Arapit nuk është masive ndaj tashmë për kritikët ka mundësi të shumëllojta për ta shqyrtuar e për të gjetur elementë dhe pika vlerësimi të ndryshme. Një ndihmë e madhe erdhi nga vetë i ndjeri që u nda ballëhapur



Fotot botohen për herë të parë

# Errësirë? Aspak e tillë!



**N**jë ftesë për rizbulimin e Europës së Vjetër dhe qytetërim it të saj rreth 8000 vjeçar në pellgun Danubian, si dhe vlerat themelore të mishëruara në të. Asnjë qytetërim nuk mund të funksionojë pa pasur vlera themelore. Por çfarë ndodh nëse këto vlera mbeten vetëm në letër? Do të shfaqen patjetër probleme të mëdha. Kohët e fundit, mes kakofonisë për ndryshimet në BE, na kërkohet jo vetëm që të ruajmë bashkësinë e kësaj aleance, por njëkohësisht të bëjmë të mundur që gjithsecili t'i gëzojë këto vlera.

Në këtë aspekt, mund të marrim disa shembuj të vlefshëm nga periudha kur shoqëri të barabarta, të shtrira në territore nga më të ndryshmet, bashkëjetonin në paqe dhe zhvillonin tregti përtej hapësirave të tyre, dhe ku gjithkush mund të përfitonte pa dëmtuar tjetrin. Bëhet fjalë këtu për mënyrën e organizimit të një prej qytetërimeve më të vjetra në botë: Europa e Vjetër, e cila – në mënyrë krejt unike në historinë e njerëzimit – ekzistoi për më shumë se 3000 vjet.

→ Vijnë në faqen 16

**Në këtë numër: HARALD HAARMANN, KATHLEEN IMHOLZ, LABGC, NDREK GJINI, MIRA MEKSI, SHAIPI BEQIRI, BAJRAM SEFAJ ETJ...**

A

ARGUMENT

NGA NDIK GJINI

**E**tiketimi euforik që i patën bërë një mbledhjeje të përbashkët të qeverisë Shqiptare dhe asaj të Kosovës, mbajtur me 11 Janar 2014, si 'Lidhja e Dytë e Prizrenit', përbën se pakti një falsitet në aspektin e historiografisë shkencore. Kjo për faktin e thjeshtë se pas Lidhjes se Parë të Prizrenit me 1878, Lidhja e Dytë e Prizrenit është mbajtur nga 16-20 Shtator 1943. Këto janë fakte historike që i përkasin të shkuarës, dhe siç e ka thënë poeti i lashtë grek, Agathon, që 400 vjet para lindjes së Krishtit, 'as vetë Zoti nuk ka fuqi ta ndryshojë të shkuarën.' Kështuqë shtypi dhe mediat e kontrolluara nga Edi Rama apo Hashim Thaci, të dehur me euforinë e tyre megalomane, duhej që se paku ta etiketonin atë mbledhje, nëse dëshironin, 'Lidhja e Tretë e Prizrenit'.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk është aspak analiza apo gjykim i asaj mbledhjeje rutine mes qeverisë Shqiptare dhe asaj të Kosovës, por të informojë lexuesin rreth fatit tragjik të Lidhjes se Dytë të Prizrenit të mbajtur, prej 16 deri me 20 Shtator 1942.

Pas shembullit pozitiv të Lidhjes se Parë të Prizrenit me 1878, të mbajtur në qytetin me të njëjtin emër, me ndihmën dhe përkrahjen e Perandorisë Osmane, në situatën e re të krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, lindi nevoja imediate e thirrjes së Lidhjes se Dytë të Prizrenit. Kjo pasi fati dhe interesat e shqiptareve të Kosovës ishin të kërcënuara seriozisht.

Disa nacionalistë shqiptarë në Kosovë dhe Shqipëri, me mbështetjen e autoriteteve Gjermane të kohës, hartuan në mbledhjen e kësaj Lidhjeje një platformë për mbrojtjen e kufijve etnike shqiptarë; kufij që ishin realisht të kërcënuar nga shovinistët serbo-malazezë të Drazho Mihajevićit dhe brigadave mikse sllavo-komuniste të disa shteteve sllave (serb, malazez, maqedonas, e bullgar).

Por fatkeqësisht, aktiviteti i kësaj Lidhjeje, u shtyp dhunshëm dhe shumë shqiptarë u vranë apo u zhduken.

Historiografia Shqiptare dhe ajo e ish-Jugosllavisë deri në vitin 1990, e kanë paratit ushtrinë gjermane si shkatërrimtare për fatin e Kosovës, por realisht gjatë kesaj periudhe Kosova përjetoi një liri, e cila për fat të keq nuk zgjati shumë. Është i njohur fakti se gjermanet, me përjashtim të zonës së minierave të Mitrovicës, u tërhoqën shpejt duke e njohur Kosovën si pjesë të Shqipërisë.

Dy muaj e gjysëm para se të mbledhej Lidhja e Dytë e Prizrenit, pikërisht me 7 korrik 1943 në Kosovë u shpall shtetërrëthimi. Çetat çetnike serbe e malazeze, në tragjedinë e Bihorit, masakruan barbarisht 4000 shqiptarë të pafajshëm. Për t'i bërë ballë kësaj situatë në Kosovë u bëemosdoshmëri krijimi i një organizmi për të ndaluar këtë revansh e keto masakra.

Në rrethanat e reja të krijuara pas kapitullimit të Italisë disa njësitë shqiptare, të ndihmuara prej disa formacioneve të vogla ushtarësh gjermane (të ardhur nga Mitrovica) morën në dorë administratën lokale të Kosovës, duke formuar Këshillat Autonome Ekzekutive. Nderkohe çetat e ashtuquajtura "çlirimtare" komuniste në Kosovë, luftonin me të gjitha mjetet për minimumin e punës atdhetare të ketyre Këshillave Autonome Ekzekutive, duke mbledhur frymën e vllavrasjes midis shqiptarëve, ashtu siç kishin bërë në shumë zona të Shqipërisë.

*Etiketimi euforik që i patën bërë një mbledhjeje të përbashkët të qeverisë shqiptare dhe asaj të Kosovës, mbajtur më 11 janar 2014, si 'Lidhja e Dytë e Prizrenit' përbën se pakti një falsitet në aspektin e historiografisë shkencore. Kjo për faktin e thjeshtë se pas Lidhjes se Parë të Prizrenit me 1878, Lidhja e Dytë e Prizrenit është mbajtur nga 16-20 shtator 1943...*



### Lidhja e Dytë e Prizrenit

Pas shembullit pozitiv të Lidhjes së parë të Prizrenit më 1878, të mbajtur në qytetin me të njëjtin emër, me ndihmën dhe përkrahjen e Perandorisë Osmane, në situatën e re të krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, lindi nevoja imediate e thirrjes së Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kjo pasi fati dhe interesat e shqiptarëve të Kosovës ishin të kërcënuara seriozisht.

# Fati tragjik i Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe spekulimi me një mbledhjeje rutinë të vitit 2014

Me 11 shtator 1943, me nismën e një grupi nacionalistësh të përberë nga ing. Xhafer Deva, Musa Shehu, Sheh Hasani, Asllan Boletini, Tahir Zajmi, Luke Simon Mjeda, Qazim Bllaca dhe Pjetër Vuçaj, u zhvillua në Prizren një mbledhje, ku u shqyrtua situata e krijuar dhe nevoja imediate e disa nismave urgjentë që duheshin marre, për përballimin e situatës së krijuar.

Tri ishin pikat baze të kesaj mbledhjeje. 1. Thirrja e një Lidhjeje me frymën e Lidhjes se Parë të Prizrenit, ku do të përfaqësoheshin të gjitha krahinat e Kosovës, Dibres, Strugës, Tuzit, Ulqinit me delegatë të zgjedhur nga populli. 2. Krijimi i një Keshilli Autonom Ekzekutiv që do vepronete deri sa të zgjidhej një autoritet legjitim nga Mbledhja e Përgjithshme e kesaj Lidhjeje. Kjo me qëllim për të mbajtur qetësinë, rendin publik dhe për t'u bërë balle situatave e reja që mund të krijohen në terren. 3. Keshilli Ekzekutiv i kesaj mbledhjeje do të merrej me përgatitjen e Mbledhjes se Kuvendit, pra të Lidhjes se Dytë të Prizrenit, hapja e të ciles do të behej jo me vonë se me 16 shtator 1943.

Keshtu pra me 16 shtator 1943 në godinën e shkollës "Bajram Curri", në Prizren filloi punimet Lidhja e Dytë e Prizrenit. Kjo lidhjeje zgjodhi Musa Shehun kryetar, Aqif Blutin n/kryetar, Prof. Rexhep Krasniqin n/kryetar e Bedri Gjijnajn sekretar. Ketu u miratuan 6 pikat e rendit të ditës, të cilat në thelb ishin të përbashkët kishin bashkimin e trojeve etnike. Në fund u zgjodhen Rexhep Mitrovica kryetar, Musa Shehu n/kryetar, Prof. Kole Margjini n/kryetar, dhe Sheh Hasani, Asllan Boletini, Tahir Zajmi, Qazim Bllaca, antare.

Ishtë data 21 shtator 1943 kur delegatët shkuan në selinë e Lidhjes se Parë të Prizrenit të 1878, dhe atje nënshkruan vendimet që Lidhja e Dytë e Prizrenit kishte marrë. Statuti i Organizatës së Lidhjes se Dytë e Prizrenit, kishte 22 nene, të ndare në disa pika.

Veprimtaria e kesaj Lidhjeje u shtyp dhunshëm me pushtimin e Kosovës nga Jugoslla-



via e Titos. Por, është i njohur fakti se përpjekjet dhe luftimet e çetave nacionalistë që vepronin në kuader të kesaj Lidhjeje nuk kane pushuar deri në vitin 1945. Komunistët serb, malazez e shqiptar që vepronin se bashku vranë e masakruan me mijëra nacionalistë të Kosovës dhe Shqipërisë që veronin në kuader të kesaj Lidhjeje.

Numri i nacionalistëve të pushkatuar mbas pushtimit sllavokomunist të Kosovës arriti në mbi 20.000 vetë, duke përfshirë ketu drejtuesit dhe organizatorët e kesaj Lidhjeje si, Musa Shehu, Prof. Kole Margjini, Aqif Bluta, Bedri Peja, Asllan Boletini, Qerim Begolli, Xhevat e Rifat Gegolli, Shyqyri Bej Ramadani, Mustafa Agushi, Sulejman Xhemal Prishtina, Sulejman Ashiku, Av. Esad Berisha, Faik Okllapi, Aqif Tetova, Isak Taniku, Av. Shaban Kamberi, Xhem Gostivari e qindra të tjere në viset e ndryshme të Kosovës e Maqedonisë.

Edhe ato pak nacionalistë që mundën të largohen nga Kosova duke shkuar në Shqipëri, regjimi i Enver Hoxhes, nuk ngurroi t'i ktheje të gjithë tek autoritetet Jugosllave, ku u pushkatuan pa gjyq. Të tillë ishin Kolo-

nel Fuat Dibra, Kolonel Asllan Vela, n/kryetar Sidki Shkupi, Major Hasha, Kapitën Hajdar Planeja, Kapitën Rasim Dajç, kapitën Hysni Rudi, kapitën Gjon Deshtanishta, kapitën Mark Thani, toger Musli Dobruna, n/toger Qazim Gostivari e aspirant Reshit Kacaniku.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore njësitet e ushtrisë shqiptare që shkuan në Kosovë, në vend që të bashkonin forcat me njësitet nacionalistë të kesaj Lidhjeje dhe të luftonin kunder atyre që po vrisnin shqiptarët e Kosovës; bene të kundërtën, vranë me qindra e mijëra shqiptarë, nacionalistë. Dhe të gjithë ketë gjakderdhje e bene për hir ideologjise komuniste.

Ky pra, që fati i Lidhjes se Dytë të Prizrenit. Keshtu që nese Rama e Thaçi tëntuan ta trumbetojnë mbledhjen e përbashkët të qeverive që kryesonin si Lidhje të Prizrenit, duhej që për hir të të gjithë nacionalistëve që organizaun dhe drejtuan Lidhjen e Dytë të Prizrenit dhe që dhane jetën për idealin kombetar; se paku ta etiketonin atë mbledhjeje rutinë të 11 Janarit 2014, me termin Lidhja e Tretë e Prizrenit.



C

ÇMIMI

Duket se karikatura shqiptare ende nuk i ka humbur karakteristikat e saj më të mira. Shembulli i kësaj ishte çmimi i fundit i artistit Arben Meksi. Më 7 tetor, në Kirenia të Qipros, atij iu dorëzua Çmimi Special nga Juria e konkursit Ndërkombëtar të Karikaturës Ndërkombëtare.

Karikatura shqiptare, prej vitesh, duket si e fjetur për shkak të humbjes së mundësisë së pasqyrit të saj. Gjithsesi, ka disa anekste të medias shqiptare që i lenë ende hapësirë, kurse një pjesë e tyre me sprovat të jashtëzakonshme po mbajnë gjallë një nga gjinitë e artit, e cila ka qenë më e persektuara pas viteve '90.

Arben Meksi, arkitekt i njohur, pjesëmarrës i rregullt i shumë aktivitetëve ndërkombëtare është nga të paktit artistë të kësaj gjinie, që jo vetëm nuk e ka braktisur, por ka bërë

*Duket se karikatura shqiptare ende nuk i ka humbur karakteristikat e saj më të mira. Shembulli i kësaj ishte çmimi i fundit i artistit Arben Meksi. Më 7 tetor, në Kirenia të Qipros, atij iu dorëzua Çmimi Special nga juria e konkursit Ndërkombëtar të Karikaturës Ndërkombëtare...*

## Karikatura shqiptare nderohet me çmim në Kyrenia

çmos ta inkurajojë, qoftë në aspektin personal por edhe të përgjithshëm. Si një nga promotorët e aktiviteteve për karikaturën, Arben Meksi, ka shfrytëzuar të gjitha llojet e resurseve intelektuale dhe jo vetëm, që ky art të mos vdesë në vendin tonë. Ndërkohë, që për të treguar vazhdimësinë, ai ka inkurajuar kolegët të marrin pjesë në konkurse ndërkombëtare, por edhe ka bërë gjithçka që ky lloj arti të mbetet në lartësi dhe duhura në vend dhe jashtë tij.

Gjithsesi, vlerësimi i fundit, që i është bërë Meksit ka treguar se ky artist ka një ego të madhe të mos e braktisë, por edhe ta përshfaqë karikaturën shqiptare me trendet më të reja ndërkombëtare, falë përcjelljes së vazhdueshme që i bën personalisht asaj më cilësore në botë, por edhe përshatjes së karikaturës shqiptare me karakteristikat e sotme.

Karikatura e Meksit ka tiparet e një gjinie thellësisht parcale dhe kjo vjen nga formimi i tij si arkitekt. Meksi ia rezervon



A. Meksi

vetes elementin e theksuar piktorik dhe e zgjidh fabulën me elementë të kursyer, zakonisht me punët me një vizë, duke shtresëzuar thellësi mendimi dhe përshatje të thellë para punës. Interesant është se çdo punë ka karakter universal dhe kjo i jep avantazhin që puna e tij të komunikojë me çdo lloj publiku në botë. Kultura e gjërë i jep gamë të madhe manovrimi por edhe gjetje subjektive, që jo vetëm të kërshtërojnë por të mbajnë ngjitur për të gjykuar.

Vepra e fundit me Pëllumbin e Paqes ka mesazh të jashtëzakonshëm ndërkombëtar sepse, shpendi mbart një degë ulliri, bashkë me folenë e vet mbi një peizazh ku gjithçka është prerë. Dilema se ku do e lerë degën dhe ku do prehet është një metaforë e jashtëzakonshme e ditëve tona dhe e bën Arben Meksin si një mendimtar me shqetësim real jo thjesht për nevojat e vendit tonë, por edhe me shumë akoma.

E

ESSE

NGA MIRA MEKSI

Pasi lexon pesëqind faqet e ngjeshura të librit më të fundit të Prof. Dr. Eshref Ymerit, *Arti i përkthimit gojor* (Intergrafika, 2018), çdo lexues do të kuptojë lehtësisht së paku dy gjëra: së pari, libri i Prof. Dr. Eshref Ymerit mbart shumë më tepër sesa jepet e shprehur në titull: së dyti, leximi i tij na zbulon një vepër e cila shpërfaqet shpërblyese në shumë rrafshet e këndvështrime, dhe për më tepër sesa një kategori e ngushtë lexuesish, siç mund të mendojë ndokush, duke u nisur nga titulli.

E shkruar me një stil të këndshëm, të rrjedhshëm, të qartë dhe të shtruar, *Arti i përkthimit gojor* është një vepër shpërblyese, më së pari, për lexuesin e gjërë, të cilit kjo vepër do t'i falë jo pak kënaqësi, dhe do t'i shuajë jo pak këshërri, qoftë në lidhje me jo pak ngjarje, qoftë në lidhje me përvoja njerëzish, përfshirë edhe syresh që nuk janë përkthyes gojorë.

Përmes paraqitjes e shtjellimit të qartë e të përpiktë të koncepteve themelore të disiplinës, Përmes një pune të palodhur, humltonimit dhe shfrytëzimit të një literature mjaft të pasur, sikundërse edhe intervistave me kolegë të tij përkthyes, *Arti i përkthimit gojor* shpërfaqet një vepër shpërblyese, më pas, për lexuesin e fushës, si me thënë, e këtu kam parasysh jo vetëm lexuesin puna e të cilit lidhet drejtpërdrejtë e përjashtimisht me përkthimin gojor, por, më së pari, studentët e gjuhëve të huaja, të cilët do të gjejnë në faqet e kësaj veprë jo vetëm një paraqitje të qartë të koncepteve të përkthimit gojor, të llojeve dhe të teknikave të tij, sikundërse dhe të misionit dhe rolit - jo rrallëherë edhe jashtëgjuhësor - që mund të luajë përkthyesi gojor, por edhe një larushi mjaft të pasur përvojash, idesh e këshillash të vyer, qoftë vetjake, qoftë të përkthyesve të tjerë, vendas e të huaj. Parë në këtë drejtim, *Arti i përkthimit gojor* mund të cilësohet pa as më të voglin dyshim një udhërrëfyes tejet i cmuar qoftë për ata që e kanë punë të tyre përkthimin

*Arti i përkthimit gojor i Eshref Ymerit shpërfaqet në një vepër shpërblyese, ndërkaq, edhe për figurën e vetë përkthyesit gojor. Figurën e përkthyesit gojor e ndeshim qysh në periudhën e lashtësisë dhe në tërë kulturat, nga ajo indiane e kineze, tek kultura egjiptiane, helene dhe romake, duke luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në gjirin e çdo shoqërie të zhvilluar. Në Greqinë e lashtë, madje, përkthimi gojor (hermeneús) shfaqte përparësi ndaj përkthimit me shkrim (metaghéro).*

# Një vepër shpërblyese

gojor, qoftë për ata që aspirojnë t'i kushtohen një pune të tillë, të cilët do të ndërjegjësohen gjithnjë e më shumë për një sërë vështirësish që shpërfaq një punë e tillë, sikundërse dhe për faktit se njohja mirë e të dyja gjuhëve në një bashkëbisedim mes njerëzish që nuk e kuptojnë gjuhën e njëri-tjetrit, është një kusht i domosdoshëm, por i pamjaftueshëm, njësoj siç është një kusht i domosdoshëm pasja e dy duarve, por i pamjaftueshëm për të luajtur në piano. Përkthimi në tërësi, dhe jo vetëm ai gojor, është një aftësi që kërkon një ushtrim të vazhdueshëm, dhe nuk mund të mësohet kurrsesi përmes mësimit të gjuhës, sikundërse dhe vetë gjuha, nga ana e saj, nuk mund të mësohet kurrsesi përmes përkthimit. Në rastin e përkthimit gojor, më pas, është domosdoshmërisht e nevojshme që *interpreti*, përkthyesi gojor, të ketë një njohje të mirë të kulturave e subkulturave që formësojnë jo vetëm stofin, por edhe horizontin kuptimor të dy gjuhëve, si dhe aftësi për të sintetizuar shpejt, duke përcjellë me saktësi dhe qartësi thelbin kuptimor të mesazhit, apo mendimit, dhe jo formën e tij, duke ndjekur kësajsoj me përpikmëri parimin e njohur të Jeronimit, Shenjtit Mbrojtës të Përkthyesve: "non verbum e verbo, sed sensum de sensu". Kjo është edhe arsyeja përse përkthyesi gojor emërtohet përmes termit "interpret"; kjo është ajo çfarë e bën të dallohet nga përkthyesi i tekstit të shkruar.

*Arti i përkthimit gojor* shpërfaqet një vepër shpërblyese, ndërkaq, edhe për figurën e vetë përkthyesit gojor. Figurën e përkthyesit gojor e ndeshim qysh në periudhën e lashtësisë, dhe në tërë kulturat, nga ajo indiane e kineze, tek



Eshref Ymeri

kultura egjiptiane, helene dhe romake, duke luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në gjirin e çdo shoqërie të zhvilluar. Në Greqinë e lashtë, madje, përkthimi gojor (*hermeneús*) shfaqte përparësi ndaj përkthimit me shkrim (*metaghéro*). Në Romën e lashtë, ndonëse përkthimi me shkrim shfaq përparësi, praninë e përkthyesit gojor e ndeshim gjithsesi të dokumentuar nga Cicero, kur shprehet se "nuk i përktheva [fjalimet e Demostenit dhe Eskinit] si përkthyes [me shkrim], por si përkthyes me gojë" (*nec converti ut interpret, sed ut orator*).

Shekuj më pas, përkthyesit gojorë luajtën një rol vërtet vendimtar në kolonizimin spanjoll të Amerikave. Komunikimi me vendasit u shfaq i një rëndësie thelbësore për Kristofor Kolombin, i cili arriti deri aty, sagë u mësoi vendasve gjuhën dhe kulturën spanjolle, për t'i përdorur më pas si përkthyes. Dokumentet e kohës tregojnë se, për të komunikuar me fiset e gadishullit Yukatan, për shembull, Hernan Kortes pati punësuar tre përkthyes; përkthyesit të parë i fliste në spanjisht, ndërsa ky ia përkthente në gjuhën maya të dytit, i cili, nga ana e tij, e përkthente në dialekte të ndryshme të zonës.

Më pas, roli i përkthyesit gojor u shfaq akoma dhe më vendimtar me krijimin e gjykatave (1563), kohë kur përkthimi gojor fitoi edhe statusin e profesionit, shoqëruar me rregullat kontraktuale. Në shekullin XX, ky rol i rëndësishëm i përkthyesit gojor doli sërisht në pah gjatë proceseve të Nurembergut, pas luftës së dytë botërore, sikundërse edhe me rritjen e marrëdhënieve ndërkombëtare, për të shmangur spiralen e komunikimit midis krerëve të shteteve që nuk flisnin të njëjtën gjuhë, çka vijon edhe sot e gjithë ditën, pa anashkaluar ndërkaq edhe veprimtaritë e ndryshme ndërkombëtare në fushat e ndryshme si rrjedhojë e prijërve globale, apo edhe rastet e intervistimit të të huajve nëpër emisione televizive apo në qendra emigrantësh, në kohët tona.

Pavarësisht rolit të rëndësishëm në krijimin e urave lidhëse mes kulturave e qytetërimeve të ndryshme, e asaj rrjete mjaft të dendur marrëdhëniesh njerëzore, shoqërore, kulturore, shkencore, ekonomike, politike etj., është fakt i pakundërshtueshëm se përkthyesi gojor, ndryshe nga përkthyesi me shkrim, ka qenë gjithnjë i mbështjellë jo rrallëherë nga harresa dhe nga anonimat. Kjo vepër e Prof. Dr. Eshref Ymerit shpërfaqet shpërblyese edhe për këtë "hero të heshtur dhe të fshehur" të kulturës dhe qytetërimit, duke i dhënë kësajsoj një fytyrë, një fizionomi, një zë. Në këtë drejtim, vepra e Prof. Dr. Eshref Ymerit shpërfaqet akoma më tepër shpërblyese për ata përkthyes gojorë që humbën jetën vetëm për shkak të ndihmesës që dhanë në mundësimin e komunikimit mes dy a më shumë njerëzve, por që më pas u ekzekutuan nga këta "për të siguruar ruajtjen e sekretit". Në këtë drejtim, vepra e Prof. Dr. Eshref Ymerit meriton pa dyshim respektin dhe mirënjohjen. Në emër të të gjallëve; në emër të atyre që nuk janë më; në emër të humanizmit.

# A

ARGUMENT

Vijon nga faqja 1

**B**E-ja u konsolidua në një kohë kur vizioni i politikës qe fuqi misht optimist dhe u projektua mbi vlera themelore që bazo heshin në përparimin njerëzor. Bëhet fjalë për dekadën e viteve 1990 kur u duk se Lufta e Ftohtë kishte përfunduar përgjithmonë dhe u besua se parimet e demokracisë do të rënjoseshin thellë në ish-vendet socialiste, dhe BE-ja do të zgjerohej vazhdimisht duke iu përmbytur gjithmonë këtyre vlerave. Ky besim ishte veçanërisht i fortë në Shqipëri, ku “të qënurit si gjithë Europa” dhe mundësisht arritja e anëtarësimit në BE ishin synimet parësore.

Por besimi në fuqinë shëruese të rendit demokratik dhe të bashkëpunimit ndërkuftar i asaj kohe është tashmë thërrmuar në të gjithë Europën. Moskuptimi i nocionit të demokracisë dhe solidaritetit u shfaq dukshëm gjatë krizës ndërkombëtare të refugjatëve, luftës në Siri, krizës së Krimesë e shumë të tjera.

Krizat po shfaqen gjithashtu edhe brenda BE-së, ku spektri i populizmit dhe nacionalizmeve po ngre krye. Kriza në Kataloni na tregon qartë se sa pranë mund të jetë fillimi i një konflikti. A mund të lejohet që komb-shtetet të sapo formuara të trondisin unitetin e brendshëm të BE-së? Nga ana tjetër, a mund të sakrifkohet autonomia e rajoneve të ndryshme në altarin e së mirës së përbashkët të BE-së nga pushtetet e forta qëndrore apo nga vendimet e Komisionit në Bruksel? Po kështu, përtej BE-së, hapja e papritur e debatit mbi ndryshimin e kufijve të Kosovës sjell një krizë tjetër të mundshme shumë afër Shqipërisë.

Për gjithë arsyet e mësipërme, ato që quajmë “vlera themelore” bëhen më të rëndësishme se kurrë, edhe pse – ose sepse – lider-shipi politik në disa vende duket se po kërkon t’i flakë ato tutje. Këto vlera përfshijnë, ato që mund të quajmë me gjuhën e Deklaratës së Pavarësisë të ShBA-ve “self-evident” (të vetkuptueshme): e drejta e vetvendosjes, barazia e të gjithëve përpara ligjit, barazia ndërmjet gjinive në shoqëri e në vendim-marrjen politike, parimet e një ekonomie tregu me dimensione shoqërore si dhe liria e individëve për të vendosur mbi vlerimet e tyre.

Nga tekstet historike kemi mësuar se grekët e lashtësisë patën idenë gjeniale, saktesisht në vitin 507 PES, të fillonin praktikën e qeverisjes demokratike e cila përfshinte disa prej këtyre vlerave. Kleisantheni mbahet si themeluesi i kësaj demokracie në Athinë, i ndjekur prej Perikliut. Çdo qytetar kishte të drejtën e votës në formimin e assembles së popullit (Eklelesia). Megjithatë, vetvendosja dhe barazia nuk ishin absolute. Gratë athinase gëzonin shumë të drejta, por jo atë të votës. Ato ishin qytetare, por qytetare pa zë. Gjithashtu, shoqëria greke ishte e ndarë në dy grupe të mëdha, në atë të njerëzve të lirë dhe të atyre jo të lirë, domethënë skllëverit, të cilët nuk ishin pjesë e vendim-marrjes demokratike. Pra, nëse hedhim një sy pas në këtë histori të demokracisë athinase dhe e perceptojmë atë si një arritje vezulluese, shkikimi ynë megjullohet në një fare masë.

E çfarë mund të themi për idetë e Revolucionit francez të 1789-ës? “Liberté, égalité, fraternité” (Liri, barazi, vllazëri) janë termat që të vinë ndërmend pothuajse automatikisht. Mirëpo, për atë kohë, këto koncepte

Luftërat, krizat, të ndërthurrura me periudha të shkurtra paqeje janë karakteristikat konstante që përshkojnë gjithë historinë e shkruar të njerëzimit. Qysh prej kohës kur Homeri na njih me Luftën e Trojës e deri në ditët tona, historia njerëzore ka trashëguar një paradigme konstante të bazuar mbi konfliktualitetin. Përse nuk shkëputemi dot prej kësaj logjike? Përse nuk përmendet kurrë fakti që ka ekzistuar në Europë një epokë më se 3000-vjeçare paqeje? Sepse në traditën tonë të edukimit gjithçka që ka ekzistuar përpara epikave homerike trajtohet si “periudhë e errët”. Përtej Luftës së Trojës dhe periudhës mikenase, errësira bëhet edhe më e dendur...

## Errësirë? Aspak e tillë!

Një ftesë për rizbulimin e Europës së Vjetër dhe qytetërimit të saj rreth 8000 - vjeçar në pellgun Danubian, si dhe vlerat themelore të mishëruara në të.

### Një pikë tjetër:

Nuk është për t'u habitur që në një shoqëri ku mbizotëruan për kohë të gjatë vlerat e bashkësisë, të thurreshin gjithashtu edhe vlera estetike të përjetshme në art. Arti i Europës së Vjetër pati një rilindje me veprën e skulptorit rumun Konstantin Brankusit. Regjizori rumun Viorel Kostea është duke realizuar një film dokumentar mbi frymëzimin që Brankusi ka marrë prej artit të Europës së Vjetër, që më poshtë përshkruhet shkurtimisht nga vetë Z. Kostea. Po në Shqipëri, a do të mund të gjejmë ndonjë jehonë të artit të Europës së Vjetër?



Tri terrakota të Shtojt

bazë ishin kontradiktore në thelbin e tyre. Fjala “fraternité” (vllazëri) na dikton menjëherë që barazia nuk përfshinte gruan – e cila vazhonte të mos votonte e të mos merrte pjesë në vendim-marrje. Pra, revolucionarëve të atëhershëm as që u kishte rënë ndërmend të kujdeseshin për barazinë gjinore.

Idetë që u ngritën në piedestal të shenjtë nga baballarët themelues të ShBA-ve në Deklaratën e Pavarësisë së 1776-ës si dhe Kushtetuta e parë e këtij vendi kishin gjithashtu kufizimet e tyre. Në atë kohë, mendohej si e pamundur t'i

jepej fund skllavërisë, kështu që revolucionarët e “shtynë” për më vonë debatin politik rreth kësaj çështjeje. Banorët e parë të Amerikës, të cilët prej evropianëve të ardhur u quajtën “Indianë” (pra, banorë të Indisë) – që në vetvete është shprehje e një paditurie të thellë – nuk përmenden fare si realitet shoqëror. Po kështu, as që u mendua që gratë, madje as ato që vinin prej Europës, të mund të kishin të drejta të barabarta me burrat. U desh lufta e përgjakshme civile e viteve 1861-1865 për t'i dhënë fund skllavërisë në ShBA. Përpjekjet e mëdha për t'i dhënë barazinë popullsisë vendase si dhe për të shtrirë tek gratë të drejtën e votës

apo edhe të tjera të drejta, arritën suksesin vetëm në shekullin e XX.

Koncepti qëndror i teorisë ekonomike moderne (në sensin klasik të përkufizimit) i atribuohet skocezit Adam Smith, në veprën e titulluar “Pasuria e kombeve” e vitit 1776, do të shndërohet në “biblën” e tregut kapitalist. Aty thuhet që tregu ekonomik vetërregullohet gjithmonë në mënyrë gati magjike me efektet që sjellin pasurimin e kombeve. Megjithatë, vetërregullimi i tregjeve u provua – më së fundmi me krizën ekonomike globale – që s'ishte veçse një mit. Ekonomisti Bengt Holmstrom, që u nderua me çmimin Nobel për ekonomi në vitin 2016, thotë se Adam Smithi nuk arriti të kuptonte se si ngjarje të paparashikueshme mund të kenë pasojë shkatërrimtare për rrjetin e tregut kapitalist. Baza e një ekonomie tregu me qasje sociale, në kuptimin e vërtetë të fjalës, nuk do të mund të formulohej përpara shekullit të XX – dhe aktualisht është e rrezikuar nga manipulimet të fuqishëm që mbeten deri diku të fshehur prej publikut (shiko [www.investigate-europe.eu](http://www.investigate-europe.eu)).

Luftat, krizat, të ndërthurrura me periudha të shkurtra paqeje janë karakteristikat konstante që përshkojnë gjithë historinë e shkruar të njerëzimit. Qysh prej kohës kur Homeri na njih me Luftën e Trojës e deri në ditët tona, historia njerëzore ka trashëguar një paradigme konstante të bazuar mbi konfliktualitetin. Përse nuk shkëputemi dot prej kësaj logjike? Përse nuk përmendet kurrë fakti që ka ekzistuar në Europë një epokë më se 3000 vjeçare paqeje? Sepse në traditën tonë të edukimit gjithçka që ka ekzistuar përpara epikave homerike trajtohet si “periudhë e errët”. Përtej Luftës së Trojës dhe periudhës mikenase, errësira bëhet edhe më e dendur.

Megjithëse shkenca e arkeologjisë ka hedhur një farë drite mbi të ashtuquajturën “periudhë e errët”, klisheja e errësirës vazhdon të qëndrojë ende sot e fuqishme. Mos vallë është e pashpresë që të gjenim gjurmë të vlerave themelore të njerëzimit nga një epokë kaq të largët?

Kohët e fundit arkeologët kanë kryer gërmime intensive në zonën e Europës juglindore, falë kjo edhe mundësive të krijuara me rënien e komunizmit në 1990-91. Sidoqoftë, edhe përpara viteve 1990, pas një pune prej disa dekadash, arkeologia lituan-amerikane Marija Gimbutas arriti të identifikojë themelet e një qytetërimit të lashtë (para indo-europian), të cilin ajo e quajti “Europa e Vjetër” dhe që sot përcaktohet gjithashtu prej disa studuesve si “Qytetërimi Danubian”, një qytetërim që shtrihet kryesisht rreth pellgut të Danubit. Në thelb të analizës së saj Gimbutas thotë se komuniteti njerëzor që jetonte në Europën e Vjetër gëzonte kushte paqësore jetese. Ndërkohë, tradicionalistët, që mbështesin teorinë e *ex oriente lux* (“drita vjen nga lindja”) dhe që shohin Mesopotaminë si djepin e qytetërimit, nuk e morrën seriozisht Gimbutasin dhe tezën e saj mbi “Europën e

**HARALD HAARMANN**, studiues në lëmin e gjuhësisë dhe të proceseve kulturore. Është autor i më shumë se 50 librave në gjuhë të ndryshme dhe ka fituar një numër çmimesh për punën e tij shkencore. Prej vitit 2003 është Zv-President i Institutit *Archaeomythology* (me qendër në Sebastopol, Kaliforni) dhe drejtor i degës europiane të këtij instituti me qendër në Finlandë.

**LABCC**, artiste që banon në Spanjë. Kërkimet e saj fokusohen në shprehjet estetiko-kulturore të formave primordiale të jetës. Puna e saj artistike hedh dritë mbi shtigje që çojnë në rizbulimin e vlerave universale të kulturave dhe ndërldhshmërisë e së gjithës.

**KATHLEEN IMHOLZ**, juriste irlandezë-amerikane e diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë Harvard. Ka ushtruar profesionin për shumë vite në Nju Jork. Që prej vitit 1996 jeton në Shqipëri, ku punon në fushën e së drejtës si dhe interesohet në gjuhësi, arkeologji dhe fusha të tjera kulturore. ]



Vjetër". Ata e hodhën poshtë këtë tezë duke e cilësuar atë si një konstruktiv të rremë nostalgjik.

Pas vdekjes së Marija Gimbutas në 1994, kaleidoskopi i njohjeve mbi "Europën e Vjetër" dhe zhvillimeve kulturore të saj është zgjeruar e thelluar dukshëm përmes gërmimeve arkeologjike, si dhe punës kërkimore në lëmin e historisë dhe gjuhësive. Ekspertët tashmë dinë që Europa e Vjetër pati zhvilluar mjete teknologjike dhe struktura komplekse shoqërore të cilat nuk ekzistonin në asnjë vend tjetër të botës në atë kohë. Rreth viteve 6000 PES, në Europën e Vjetër pati filluar një fazë zhvillimi e cila çoi në lindjen e një kulture të avancuar. Të paktën aty rreth viteve 5300 PES Europa e Vjetër kishte arritur majat e zhvillimit botëror në fusha të tilla si:

- Kovaçët e Europës së Vjetër zhvilluan teknika shkrirjeje të metaleve, fillimisht të bakrit (rreth 5400 PES) dhe më pas të arit (rreth 4600 PES) duke bërë të mundur shkrirjen e bakrit në tonelata të tëra si dhe krijimin më të hershëm të objekteve artistike prej ari. Shumë objekte bakri të kësaj periudhe janë zbuluar gjithashtu në zonën e Maliqit dhe disa prej tyre ka të ngjarë të jenë prodhuar po aty.

- Banorët e Europës së Vjetër ndërtuan struktura banimi dy-katëshe dhe tempuj me përmasa monumentale.

- Sistemi i shkrimit që ata përdornin është më i vjetri në botë, të paktën 1500 vjet më i vjetër se shkrimi egjiptian dhe sumerian. Ata gjithashtu patën përdorur një sistem simbolesh po aq të vjetër për numrat.

- Në mijëvjeçarin e pestë PES, qytetet e para kishin lindur, disa prej tyre me më shumë se 10000 banorë dhe shtriheshin në një gjërësi prej rreth 400 hektarësh. Ka të dhëna se funksiononin me një infrastrukturë administrative me "këshilla qytetarësh" që organizoheshin në bazë lagjesh e udhëheqeshin nga lider i zgjedhur nga banorët.

Një gjë që nuk ekzistonte në Europën e

Vjetër, sepse nuk kishte nevojë, ishin kufijtë politikë. Popullsitë e rajoneve të ndryshme ndërvepronin me njëri-tjetrën në një mjedis që ishte pothuajse tërësisht pa konflikte të dhunshme. Ajo që i bashkonte këto popullsi ishin tradita kulturore dhe struktura e tyre shoqërore, por mbi të gjitha, interesat e përbashkëta ekonomike. Mirëqenija e Europës së Vjetër ishte e bazuar në tregtinë intensive që zhvillohej përgjatë bregut të



Ritoni (i restauruar) nga Dunaveci (Korça), epoka neolitike e mesme

Danubit (prej nga lind termi "Qytetërimi Danubian") si dhe zonave përreth tij. Tregtia detare shtrihej nga brigjet e Detit Mesdhe deri në Detin e Zi, duke përfshirë gjithë

Balkanin dhe Shqipërinë e sotme. Vinëa (në Sërbinë e sotme), Turda\* (në Rumaninë e sotme) dhe Varna (në Bullgarinë e sotme) ishin të gjitha qendra të rëndësishme tregtie.

Në Shqipërinë e sotme, Maliqi është ndoshta më i njohuri ndër këto qendra të lashta, por padyshim që ka edhe të tjera.

Lidhjet tregtare përfshinin të gjithë ata që merrnin pjesë në to dhe që e bazonin biznesin e tyre në atmosferën e një besimi të ndërsjellë. Çfarë roli do të kishin luajtur kufijtë politikë në një kontekst të tillë? Besimi reciprok ishte çelësi i funksionimit të Europës së Vjetër. Zgjerimi i fuqisë së rrjetit tregtar në atë kohë nuk mund të mendohej pa këtë bazë të besimit tek tjetri. Ky rrjet shkëmbimesh tregtare arriti të shtrihej në Azinë e vogël (Anatoli), drejt veriut (deri në Poloni) dhe drejt perëndimit (Francë dhe pjesën jugore të Anglisë). Rrugët tregtare mbulonin kështu një gjatësi mbi 3000 km. Kërkimet mbi Europën e Vjetër tregojnë që shoqëritë e mbuluara nga ky rrjet i gjërë shkëmbimesh karakterizoheshin nga barazia dhe nga një funksionim demokratik i strukturave administrative, ku mbitzëronte paqja:

Gratë kishin barazi me burrat në Europën e Vjetër. Arkeologët bien dakort që shumica e prodhimeve ishte rezultat i punës së përbashkët të grave dhe burrave, dhe mendojnë gjithashtu që tregtia përgjatë lumjeve ka shumë mundësi të ishte në dorën e grave.

Në qytetet e asaj periudhe nuk ka shenja lagjesh elitare apo mbetje ndërtimeve luksoze, thjesht sepse nuk ekzistonte një grup elitari që ta pretendonte këtë status. Varrezat dhe sendet e gjetura në to nuk japin asnjë provë për ndarjen e shoqërisë në të pasur dhe të varfër. Në disa raste, në varre grash janë gjetur sende simbolike, por që lidhen më shumë me njohjen e tyre si themeluese të fisit apo të familjes së zgjeruar.

Arkeologët nuk kanë zbuluar mure mbrojtëse rreth qendrave të banimit, qofshin këto fshatra apo qytete; si dhe në asnjë

→ [Vijon në faqen 20](#)

## Konstantin Brankusi (1876-1957), babai i "artit të vjetër modern"

NGA VIOREL KOSTEA

Nëse do të vendosni objektet artistike me origjinë nga Europa e Vjetër që janë zbuluar këto vitet e fundit pranë punëve të Brankusit dhe të ndiqni linjat e format, apo minimalizmin e tyre, atëherë do të mund të shihni lidhjen ndërmjet kujtesës kulturore dhe frymëzimit personal të artistit. Kjo i dha forcë qëndrimit artistik të Brankusit kur ishte ende i ri, në atë pikë sa që të linte pas dore mundësinë e mësimin në studion e mjeshtër August Roden vetëm pas pak kohe, në mënyrë që të realizonte me vullnet dhe imagjinatë vepra artistike që nuk mund t'i kishte parë kurrë.

Jeta dhe veprat e tij gjeneale tashmë njihen si të famshme në të gjithë botën. Vepra të tilla si "Princesha X", "Zonjusha Pogany", "Zog në hapësirë", "Peshk" dhe shumë të tjera, janë krenaria e disa prej muzeve më të njohur kudo në botë, nga Bukureshti në Paris apo Nju Jork. Jo më pak i famshëm është asambli monumentale në qytetin Targu Jiu (Rumani) i cili përfshin "Tavolina e heshhtës", "Porta e puthjes" dhe "Shtylla e pafundme".

Konstantin Brankusi lla fshatin e tij të origjinës, Hobita në Rumaninë jugore, në moshë të re, shumë i varfër, por shumë i talentuar. Rrugëtimi i tij formues kalon nga Krajova në Bukuresht, Mynih dhe së fundi në Paris. Gjithmonë i palodhur, gjithmonë i përqëndruar në idetë e tij, kryeneç, gjithmonë në kërkim të përsosmërisë. "Të krijosh si Zot, të urdhërosh si Mbret, të punosh si Skllav" ishte motoja e tij. Gjatë



Konstantin Brankusi

rinisë së tij ka punuar si asistent në atelie të ndryshme me mjeshtër të ndryshëm. Skulpturë, fotografi, pikturë. Ditë pas dite, çdo ditë. Gjatë gjithë jetës së tij, me kalimin e viteve, prekjeja e tij shumë e veçantë artistike dhe karakteri personal që spikat, do të përcaktonte një botë të re në skulpturë: Arti Modern.

Megjithatë, thellë në shpirtin e tij, pavarësisht nga nderimet e marra, pavarësisht pasurimit të jashtëzakonshëm, deri në fund të jetës së tij në Paris, mbeti një fshatar i thjeshtë nga Hobita. Dramatik, i pagdhëndur dhe kryeneç. Eshhtë fakt i njohur tashmë që vepra e tij mbart në vetvete trashëgiminë e folklorit rumun, në forma, linja dhe ide. Por, mbi



Konstantin Brankusi, portret i zonjes Pogany, 1912

të gjitha, ajo buron nga thellësia e zemrës së tij.

Zbulimet arkeologjike të dekadave të fundit kanë hedhur dritë mbi disa aspekte të reja që lidhen me punën e Brankusit. Artefakte të datuara prej kohës së Europës së Vjetër, të zbuluara përgjatë gjithë Europës juglindore, shfaqin të njëjtat linja, forma e harkime si ato të "artit modern" të Brankusit. Për më tepër, në varrezat e dy fshatrave në Transilvani, disa varre që në vend të kryqeve kanë kolona, dhe që datojnë nga koha e dakëve, na kujtojnë menjëherë veprën "Shtylla e pafundme". Një provë tjetër e njohjes së thellë që ky fshatar nga Hobita

kishte për historinë e artit, duke përfshirë këtu edhe atë pre-historik të periudhës neolitike, të Europës së Vjetër - një kohë paqeje, vazhdimësie dhe respekti për qëllimet e përbashkëta, një kohë kur njerzët besonin njëri-tjetrin.

Njerëzit që jetonin në Europën e Vjetër 5000-8000 vjet përpara e dinin dhe zbatonin në mënyrë të pastër dhe të thjeshtë parimet e drejtësisë dhe barazisë ndërmjet njerëzve bazuar mbi interesat e përbashkëta dhe besimin reciprok. Asnjë luftë, asnjë kufi, asnjë hierarki. E gjithë kjo e parë nga "lartësia" e epokës sonë moderne duket duket si një botë e pamundur dhe e çuditshme, apo jo?

Mirëpo, kjo botë ishte reale dhe zgjati për më shumë se 3000 vjet deri sa njerëzit vendosën ta "modernizojnë" jetën në çdo aspekt të saj. Sot kemi konflikte të zjarrta në çdo moment, kudo në botë. A është ky moderniteti i duhur?


Për më tepër, është fakt i provuar që ne kemi mundësi t'u mbahemi vlerave të mirëfillta e t'i respektojmë ato, që ne të kuptojmë çfarë nënkuptojnë fjalët besim, drejtësi apo interesat e përbashkët. Ndoshta duhet që t'i vemë në jetë më shpesh. Kemi fatin që të kemi kudo rreth vetes disa prej shembujve më të mirë të vlerave të përditshme. Artin. Përgjatë mijëvjeçarëve, arti i lashtësisë është me ne, si një dritare mbi të harruarën, e cila falë punës së arkeologëve është bërë çdo ditë e më pranishme.

Shembujt janë pafund. I referohem vetëm më të famshmit, Konstantin Brankusi. Skulptori. "Ati" i artit modern. Vlerat e historisë mundet edhe duhet të sillen në të tashmen tonë. Këtë mund ta bëjmë. E bëri Brankusi. Ai bëri shumë më tepër. E gjithë kjo histori do të trajtohet në dokumentarin me me trazth të gjatë "Trashëgimia e fshhtës e Brankusit" (punë në zhvillim)

## P

## POEZIA

Për herë të parë vjen në faqet e "Milosao" një autor kosovar me një poezi interesante, të pasur me një figuracion interesant dhe fabula tepër të ndjera...



## Shënim bibliografik

Shqipëri Shqipëri lindi më 25 mars 1954 në Gllamnik të Besianës (Kosovë). Ka mbaruar studimet në Degen e Letërsisë dhe Gjuhës Shqiptare në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, ku ndoqi edhe studimet pasuniversitare. Beqiri ka nisur të botojë poezi në fillim të viteve '70.

## Ka botuar librat themelore të poezisë:

Fontana e etjeve, *Rilindja*, 1976, Prishtinë; *Konica*, 2006<sup>2</sup>, Prishtinë, *Flatrat e gjymta*, *Rilindja*, 1983, Prishtinë; *Konica*, 2016<sup>2</sup>, Prishtinë *Eklipsi i gjakut*, *Pashku*, 2000, Prishtinë; *Konica*, 2017<sup>2</sup>, Prishtinë *Muranat e muzgut*, *Konica*, 2015, Prishtinë; *Uragani i zhurit*, *Konica*, 2018, Prishtinë;

Librat e zgjedhur të poezisë:

Rekuem për veten, *Buzuku*, 1997, Prishtinë, *Prangat e praruara*, *Toena*, 1998, Tiranë, *Hinoret e njejtë*, *Konica*, 2016, Prishtinë,

## Librat e përkthyer të poezisë:

*Između dva ponora / Ndërmjet dy humnerave*, *Jedinstvo*, 1988, Prishtinë, përkthyer serbisht nga Ramadan Musliu, *Hydra des Zorns / Hidra e mllëfit*, *Limmat*, 2014, Zürich, zgjedhur e përkthyer gjermanisht nga Hans-Joachim Lanksch. Shqipëri Shqipëri nga mesi i viteve '70 merret me redaktim, publicistikë dhe përkthim. Në fillim që mesimdhënis në Gjinnazin e Besianës, pastaj në vjetet 1976 - 1977 redaktor i rubrikës së kulturës i gazetës së studentëve të Kosovës *Bota e re* në vjetet 1977 - 1993 poashtu redaktor i rubrikës së kulturës e revistës *Zëri* në vjetet 1978 - 1990 bashkëpunëtor i ndërmarrjes botuese *Rilindja* në vjetet 1990 - 1995 bashkëpunëtor i ndërmarrjes botuese *Gjon Buzuku* në vjetet

1990 - 1992 anetar i redaksisë i të përkohshmes për kulturë, art e letërsi *Fjala* ndërkaq në vjetet 1993 - 1994 e themeloi dhe e udhëhoqi (bashkë me Adem Demacin) të përjavshmen politike *Forumi* dhe më 1995 (me Teki Dervishin) të përjavshmen letërisht *Zeniti*.

Një pjesë e veprës poetike të Shqipëri Shqipëri është botuar edhe në gjuhë të tjera, si gjermanisht, anglisht, frëngjisht, serbisht, rumanisht, kroatisht etj. Ai është paraqitur në shumë antologji të ndryshme të poezisë si dhe në manifestime e lexime letërisht: poashtu ka fituar çmime të shumtë letërisht. Shqipëri Shqipëri nga vjetet 1995 jeton në Zvicër.

Edhe në mërgim ka vazhduar krijimtarinë në fushë të letërsisë dhe të publicistikës duke bashkëpunuar me revista e gazeta të ndryshme: *Eurozëri*, *Bota sot*, *Java shqiptare*, *Zëri ditore* etj. Është anetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës nga vjetet 1976 dhe i Shoqatës së Shkrimtarëve të Zvicrës nga vjetet 1998.

## NGA SHAIPI BEQIRI

Lasgushiana:  
VDEKJA E NOSITIT

Ja së fundi ju flas me zjarr  
Në zemrën time çela një varr

Thelle e mbolla për llahtari  
Sa mos ta shuajë asnjë stuhi  
Mu në velen time një dashuri

Nuk e vitihis as deti zemërak  
Me valat që s'iu ndava aspak  
Kur vetullat ua bera me gjak

Perjetësisht përsëri ju flas  
Gjirin godas ah zogjtë i qas

PËRTEJ URËS ME  
FLATRA

Babai për një cast  
M'u bë urë me flatra  
Tejendani lumit pa fund  
Që s'e kaloja dot as në ëndrra

Nëna një lule e çelur së dyti  
Në bregun tjetër të kohës

Njëra gjyshe sodiste me një sy  
Grijën e përgjysmuar të reve  
Kur gjyshi trazonte terrinen  
Me një skeptër të padukshëm

Thinjoshja ime tjetër  
Ujkun nxirrte nga valtha  
Dhe fustle dashurinë në qivur

Ndërmjet dy psherëlimave  
Shtrihet shkretëtira e jetës  
Që duhet kaptaur symbyllur  
Gjurmave të gjyshit të tretur

Lart zgavrat pa mbarim  
Nepër të cilat përkohet  
Vallja e madhe e shprishjes

Poshtë maja të thepisura  
Përgjumur mes mjeçullash  
Përkundin ëndërrueshëm  
Çerdhe të prishura dejkash

Unë pritja rrënjë të shijta

MIDIS KATËR  
ERËRAVE

Në Veri e kisha edhe një Veri

Prej andej erdhi Gjergji  
Drejt Vendenisit për në Krujë

Bogdani nisi bocat e para të Çelës

Unë kam mbetur këtu një torzo  
Trung në hi i kthyer kah dielli  
Midis katër erërave që më zhbënë

Tutje-tëhu gjithkahnajës  
Toka gjëmëmadhe çare në syngji  
Re e mjeçulla prerë ndër shkëmbinj  
Dhe detët ah të tretë me futën në sy

Nepër ta u bart koka e pashait të Zi

U këput vallja me shpatat zhveshur  
U shprish gjaku i Boçarëve pa shterur

Në Jug më mbeti cung edhe një Jug

RRUNGAJA NË  
UDHËKRYQ

Sypërgjumur i shoh nga dritarja  
Si më sulen me tërbim katalanësh  
Pamjet që ndërrohen nën re të rrepeura  
Të tokës me reliev të ashpër  
Shkëmbinjsh e bregoresh mveshur  
Dhe fushash që ngrysen lakuriq  
Duke u futur në gjë të njëra tjetres  
Në lojë të perjetshme e pshndjellëse  
Lesbikë të përbuzura perkohësisht  
Nga lumenjtë që derdhen tutje të dehur  
Duke krijuar lumin e madh nëntokësor  
Perfundi rrjetash të mpira silnash  
Që mbajnë magmën e një vullkani  
Pak para se të shpërthejë në mua  
Heshitjen ogurze të shekujve  
Që noton drejt zemrës së tokës  
Duke u përplasur rrëkëllyeshëm  
Me atë rrungaje të etur akullnajash  
Mbërthyer në udhëkryqin e zhbërjes  
Që llirinë futi në peshkve të nxirrte Ballkan

LUTJA E  
PARAFUNDIT

Ati im i përdritur  
Bëje muzikë të hyjnueshme  
Fjalën që më mbeti në grykë  
Nxirrme purgatorit të heshitjes  
Mos më nguroso kaq të rrektorur  
Në trajtë idhujsh të choroditur  
Me koka të këputura nënsqetullave  
Përgjumur pas perëndish të peshlyra  
Nder krifa të kreshperuara katalanësh  
Ferfellomë duke më vërvitur  
Galaktikave të flakës sime të etjes  
Ngujomë në rrethin e dhjetë të ferrit  
Para gjunëve të tu më plandos  
Në tjetër para një llahtaritur  
Nën pëlhurën gjak-e-dhe

NË RRJETËZA  
FUNDËNDRASH

Sa fort ju kam dashur  
Gra që gërvishiet me thonj  
Faqen e lëmuar të jetës sime

Ndonjëra  
Ndoshta edhe mua më ka dashur  
Me shumë zjarr e ankth

Dhe me fshetësi përkshuar

Ndonjërisë i kam zbërthyer  
Zymbylët e paprekur kurri  
Në kraharonin e enjtur  
Dhe me të dyja duart  
Kam hedhur në erë  
Trëndallitë të eger puthjes

Në sytë tua fërgëllues  
Kam soditur tek vërliten kuturu  
Galaktika ëndjesh pa mbarim  
Dhe ndonjë curril i hollë gjaku  
Në hon psherëtimash të këputura

Ujëvara të panumërta rrekëllyese  
Që fashitin gjemimin  
Drejt zemrës së etur të tokës

Thellë ndër rrjeta rrënjash  
Tash me pret gruoja gazmore  
Me më ngujuar përgjithmonë  
Në qelitë e veta të merisë

## DITA QË MË VRET

Vetem do të rreshas kurrit të kesaj dite  
Duke ia shpuaritur përsëri lulen e ballit

E ndiej largas që do të jetë veç imja  
Dita që më vret fshetlas syve që i ndrijnë  
Në çastin kur vërvitet rrezomes së vet

Dhe unë më kot hepoem kaçurrellit të saj  
Që duket fllorë e thërrmur drejt gremisjes

Do të ngrysem ndanë humbellës sime  
Duke ngritur gurin e saj të stërmadh  
Te maja e mallit të mesnatës së mehur

## GOZHDA PA KOKË

Ja liria  
Që me shekuj kërkaut  
Na u çor shpirtmbajtësi me skeptër  
Ne robove të vet të lumturuar

Qafekëputur ramë në gjunj  
Skaj pyllit të hijeve tona

Merreni lirinë e sapofarkelutuar  
Venë në pjatë të praruar  
Me blanka gjaku

Një gozhde pa kokë

Tejshkuar shtrëmber  
Shpirtin na mban pezull  
Ndërmjet dy regjetimave

Ç'iri e paanshme  
Me push endrash  
Llapashitet ndër bërraka

Ky shpend i stërmadh  
Me krahë të thyer  
Që hov të dalë  
Nepër dritaren e mbyllur

KËRMAT E  
SHPËRMENDURA

Varratë duarpërlyer mëdysjesh të pabesë  
Trumbë e zvarritur pas ndonjë kërme të gjallë  
Që vërvitet përballur duke shuar çdo shpresë

Oenë e bij qenësh  
Lindur prej incesti me damkë  
Blatur në gjak të ngjizur me qelb-e-helm  
Lapërdharë të roposur urrejtesh pa anë

Shpoltitni yllin në majat e përflakura  
Ulerimi pasi s' dini të renkoni  
Këlyshe të verber ligësisht  
Që me djaj kulërboni

Aldheun e duani të skuqur si sytë tuaj  
Të përdhosur me afsh përveluar  
Prapa grilësh të shumëfishuar

Eunukë e pshëmrdhezur  
Nga fundi i fundit të ferrit  
Nakatatos peshkves e territ

Bij vrasarësh pa dëshmitarë  
Tinëzare pa shenja gishtëringsh  
Nuk dini të heshitni as të qeshni  
Zulmëzinj me vurrata gjarpinjsh

Fundbark-personazhë-zhveshur të zhbërjes  
Dhjam-fjalash-blitur komedish të pështrira  
Që rrjedhin duke derdhur jargë-e-sperme  
Mespërmas palces me dhembje të mpira

TEMPULLI  
I HESHTJES

Mblodhe tërë heshitjen rrotull bedenëve  
Dhe bëre murin tend të fjalës

Gur mbi gur  
Hap pas hapi  
Deri të maja

Ngrile pasqyrën e përmbysur  
Kundruall fityres së diellit

Shkëpute shkëmbin vargmalit të fjetur  
Ku bora me borën bëjnë mur të gjallë  
Me mbuluar eshtrat e mbetur përde  
Dhe të yesh një hap me afer ëndrës  
Një dhembje përtej gurit të varrit

Reja që ndërzehej rrallë barkun cau  
Nder gropa të zeza  
Në udhën pa anë  
Pas një ylli

Ti ushqeve harrësën e mbrusur  
Me shpresat e mia të unta  
Ta bësh përsëri tempull  
Heshitjen me myk e ar

## HIJA E KIPCIT

Midis flakës që më mbeshitjell  
Unë përsëri vdes  
Për të dytën  
Të tretën  
Për të dhjetën herë

Kokën ma vënë në shënjestër  
Gjahlarë të perhënur  
Dhe qëllojnë sall hijen  
Që bredh në mua  
Duke ikur nga vetja

Lasgushiana:  
YLLI I ZEMRËS

Mblidh mermerin e kelij muzgu  
Derdh sipër pluhur purpuror  
Gdhend zurrkaja fiale nga çurgu  
Që thyhet thelle duke u tretur  
Magmes në përplasje gjymtyrash  
Kurrijehere brenda pa u prekur  
Nepër lahuri gjaku e ngjyrash  
Shjellave të dehur me dritën  
Mbërthyer në putra të sfinksit  
Që Yllit të Zemrës i zë priten

Nga libri "Uragani i zhurit"  
për suplementin "Milosao"  
zgjodhi: Bajram Selaj

TORZO E KTHYER  
KAH DIELLI



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri duket konsideruar relativisht një numër i qetë. Redaktori i kushtoi një shkrim në shenjë homazhi Mirash Ivanajt, edhe pse kishte pak rezerva në lidhje me rolin e tij me mbylljen e shkollave të huaja dhe ato të fesë. Vetëm se e ka parë me një optikë më ndryshe, që ka të ngjarë të ishte edhe rruga më e mirë në pasqyrimin e tij. *Mirash Ivanaj haset pak e gjithnjë shumë pak në literaturën tonë. Madje, edhe atë ditë vjeshtë, 65 vjet më parë, kur do të ndërronte jetë, ai pothuaj ishte harruar. Kurrë nuk mund të kesh trishtim më të madh në të gjallë sesa të harrojnë. Kjo i ndodhi, njërit prej personaliteteve më të jashtëzakonshme të kulturës dhe arsimit shqiptar. I ngrati erdhi me një formë shumë dashmire, i ftuar nga kolegu i tij, që asokohe ishte bërë Ministër i Arsimit, Gjergj Kokoshi dhe përfundoi në burg si ai. Epilogu ishte i dhimbshëm sepse vdiq në burg vetëm pak ditë para lirimit. Për idenë e tij, redaktori pati dhe shtysën e Maks Velos, që i ofroi katër portrete të Ivanajt. Kjo figurë e kish bërë për vete arkitektin dhe piktorin e njohur, të cilit i ka kushtuar këtë cikël dhe madje dëshiron t'ja dhurojë fondacionit me të njëjtin emër. Shkrimi tjetër interesant ishte i zotit Mehmet Elezi, sa i përket Çetobashe Muja kundër Gjeta Basho Mujit. Në fakt ishte ky shkrim që duhej të hapte Milosao në këtë numër sepse ishte tejet teknik dhe shumë i maturuar. Deri sot kurrkush s'e ka vënë në dyshim emrin e kryeheroit të epikës legjendare Gjeta Basho Muji. Herë-herë ka qarkulluar një legjendë me burim të paqartë,*

*sipas të cilës emri Gjeta do të thotë I Gjetuni. Sepse Muji paskësh qenë "fëmijë i gjetur". Shihet se diçka nuk shkon në këtë legjendë. Emri Gjeta ngjan si nofkë. Ai i gjeturi, ai i rrugës. Nofka përban me shumë se shpërfillje. Kjo nuk përputhet me mendësinë shqiptare. Shqiptarët nuk i përbuzin heronjtë dhe mitet e tyre. Muji, bashi (balli) i të gjeturve? I gjeturi që ka zënë bashin (ballin)? Një rrefim interesant për eposin e shqiptarëve, shkroi autori.*

Në këtë numër, redaktori, ka lëshuar pak vend për një kontribut të ardhur nga shqiptarët e Malit të Zi. Një grup simpatik intelektualësh duke hulumtuar trevat e vjetra të ilirëve...Gazmend Çitaku me foto të Sami Flamurit dhe Gëzim Mavriqit na kishin sjellë disa vështrime nga ilirët që kanë banuar në trojet e sotme në Mal të Zi. Megjithatë janë pak patetike, redaktori i vlerëson bashkëatdhetarët, me të cilët ka pasur edhe relata miqësore për punën e tyre ndaj shqiptarizmit.

Sokrat Paskali na kish sjellë një cikël me të cilin tentonte një poezi filozofike dhe duhet thënë se arrinte ta realizonte qëllimin e tij me një figuracion të kujdesshëm, që përmbledhje brenda një forme moderne... Në përgjithësi ishte një numër i mirë dhe duhet thënë se edhe layout kishte punuar disi mirë dhe me një loj impenjimi të këndshëm.

S

SKULPTURA

Artisti Ermir Grezda në kuadër të 70-vjetorit të tij hapi një ekspozitë me një numër punësh për të treguar stادت e zhvillimit të artit të tij, por edhe sfidat e së ardhmes...

# Ermir Grezda, i zhgënjyer me trajtimin e artistit të ditëve tona

NGA STAFF MILOSAO

Skulptori Ermir Grezda, në ditët e fundit, ka promovuar në Tiranë një përmbledhje artistike në prag të 70-vjetorit të lindjes. Gjithsesi, ekspozimin e veprave të tij në skulpturë dhe albumit të tij, e ka bërë larg mjediseve artistike zyrtare duke e menduar edhe si një formë reagimi ndaj indiferencës se madhe të këtyre strukturave ndaj artit të brezit të vjetër të artistëve shqiptarë. Zhgënjimi më i madh personal i artistit ka qenë që nuk gjeti një hapësirë përfshirëse nderimi në Galerinë e Arteve. Një fakt, që e ka shprehur shumë zyrtarisht, por edhe në mjediset ku promovoi krijimtarinë e tij gati tre dekadike.

Në aktivitetin e skulptorit, të pranishmit, i janë kënaqur ekspozimit të veprës së vet, ku subjektet e Grezds kanë të plazmuar plastikën e nevojshme dhe fjalës që ai ka ndarë bashkë me mesazhet e veprës së vet. Autori ka qenë shumë i dhënë pas skulpturës së parkut dhe ka apeluar vazhdimisht që artistët e skulpturës e kanë vendin e tyre të ekspozimit në natyrën e bukur shqiptare, ku tradita e ndërthurur me trendet e të resë mund të shfaqin shumë nga vlerat kombëtare dhe jo vetëm. Veçse, që të ekspozohen, skulpturat kanë nevojë të përshfaqen për publikun dhe me mjediset që ofron Tirana dhe rrethet është e vështirë për artistët e skulpturës të gjejnë veten e tyre. Ky është shqetësimi normal i Grezds që mbarë mbi shpatulla një përvojë disa dekadike duke i dhënë jetë subjekteve, ku është hyjnzuar figura antropologjike shqiptare dhe jo vetëm. Si të gjithë artistët, ngacmimi ka qenë në figurën femërore dhe plastika e formës dhe zgjidhjet e ndryshme e kanë treguar si një autor me shumë parametra të lartë estetikë. Është fakt, ka ndarë ai opinionin e tij me publikun, se e ka intriguar shpesh figurinat e nënës edhe të bukurisë së femrës shqiptare, madje subjekte me të cilat ai është marrë qysh në fëmijëri. Madje, ato i kanë dhënë jetë skulpturës së tij të vlerësuar "Nëna dhe fëmija", ku në vepër figura e Nënës ka treguar një domethënie të madhe, që ai e ka treguar në të gjithë vepren e vet.

Grezda ka dhe një mori të tëra subjektësh të veta, fryt i përsiatjeve, që e kanë bërë të tregojë shumë impenjim në tematika të ndryshme të vendit. Gjithsesi, këto nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe strukturat zyrtare shqiptare nuk e kanë marrë shumë parasysh këtë impenjim dhe kanë treguar se janë shumë indiferente ndaj tij dhe



Ermir Grezda

artistëve si ai.

Në fakt, fati i tij nuk është i vetëm, pasi me të tillë sfidë ballafaqohen dhe artistët tjerë, sidomos në rrethe, ku punët e tyre pothuaj nuk ekspozohen fare. Megjithatë, kjo ishte pak, para vlerësimit që Grezda ka marrë nga kolegët e tij në këtë stad, ku ka arritur krijimtaria.

Grezda është një skulptor shumë klasik, sa i përket tematikës që zgjedh por edhe realizimeve që ka bërë...

**CILI ËSHTË?!**

Skulptori Ermir Grezda i lindur në Tiranë dt. 13.08.1949, fillesat e krijimtarisë të tij i ka të formësuara në studion e të atit, Qamil Grezdes, Odhise Paskalit, Kristina Koljakës dhe Llazar Nikollës.

Ai është diplomuar në vitin 1967 në Liceun Artistik "Jordan Misja" në atelienë e



me çmimin e parë. Është pjesëmarrës në ekspozitat lokale dhe kombëtare, prej vitit 1970, në ato të çlirimit dhe me tematikë të ndryshme, si ekspozita e 500 vjetorit të Skënderbeut, të Ushtrisë, të Atdheut e të Bujqësisë. 1988 – Ekspozon ne Catanzaro, Itali  
1989 – Ekspozon ne Ciro Marino, Itali  
1992 – Sekretari Shoqates Mbareshqiptare te Aristeve Figurative  
1992 – Ekspozita Retrospektive Qamil dhe Ermir Grezda, GKA  
1993 – Ekspozite Cafe des Artist, Pallati Kulture, Tirane

1995 – Ekspozita, Qamil dhe Ermir Grezda, Qendra Nderkombetare Kulture  
1998 – Panairi i Artizanatit, Punime Hekuri, Tirane – Bari, Itali  
1998 – Ekspozite e Skulptures Ermir Grezda, Qendra Nderkombetare Kulture  
2000 – Ekspozite e Skulptures Ermir Grezda, Gjakove, Kosove

2002 - Ekspozite e Skulptures Ermir Grezda, Prishtine, Kosove

2003 – Ekspo Lux 2003 Kopenhagen, Danimarkë

2004 – Ekspozita Qamil dhe Ermir Grezda, ne Abasaden Amerikane ne Tirane

2005 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy

2006 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy

2007 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy

2008 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy

2009 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy

2010 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy

2012 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy

2014 – Ekspo Auditorium Duomo, Firenze, Italy



profesor Andera Manos, Llazar Nikollës dhe Naxhim Bakallit. Me pas ne Akademine e Arteve ne Atelienë e Skulptures Monumentale, te cilën e mbaroi ne vitin 1972, me prof. Mumtaz Dhrami, Thoma Thomai, Salë Shijaku dhe Shaban Haderi.

Prej vitit 1972-1992, punoi ne sektorin studiomir dhe cicerone i Galerise Kombetare te Arteve

Figurative, TIRANE. Prej atij viti dhe deri me 2014, Pedagog i Ateliesë se Skulptures dhe Materialeve te Forta, ne Liceun Artistik "Jordan Misja", Tirane.

Ne 40 vitet e krijimtarisë në skulpturë ka trajtuar mjaft vepra në gjininë e kompozimit, portretit, ne qeramike, hekur, bronz, gur etj.

Ermir Grezda është pjesëmarrës në ekspozitën e rinisë 1971, i cili u nderua

R

REVIEW

Mimoza Kuchly është një nga autoret më të reja, që i shtohet grupit të shkrimtareve, të cilat mëtojnë të shkruajnë për psikologjinë e femrës në kohët tona. Fryt i angazhimit të saj është libri me tregime e novela "Rrëfej unë, gruaja", ku lexuesi përfshihet në këqyrjen e subjekteve, që ndërlihen direkt me rravimet psikologjike dhe sociologjike të autorese...

## Dëshmon gruaja

NGA BEN ANDONI

Mimoza Kuchly është një nga autoret më të reja, që i shtohet grupit të shkrimtareve, të cilat mëtojnë të shkruajnë për psikologjinë e femrës në kohët tona. Autorja jonë ka dhe një avantazh në këtë grup, pasi është e formuar në degën e Sociologjisë, përveç formimit të saj letrar. Pikërisht, ngasja e kësaj dege, ku përbalja e shumë rasteve dhe fenomeneve bën që të dalin përgjithësisht për kohën ku jetojmë dhe jo vetëm, e kanë bërë Kuchly të shtyhet më tej dhe ta përcjellë përvojën e saj në letërsi. Fryt i angazhimit të saj është libri me tregime e novela "Rrëfej unë, gruaja", ku lexuesi përfshihet në këqyrjen e subjekteve, që ndërlihen direkt me rravimet psikologjike dhe sociologjike të autorese. Ajo zgjedh zakonisht në pozicionin e rrefimtarit vetën e parë dhe ky është momenti, ku një lexues gjykon përgjithësisht që autori vetëmbart në shtjellën e subjekteve të veta. E veçanta e autorese është se shkruan në një formë shumë urbane, por pak si të huaj për publikum tonë, duke e trajtuar subjektin e saj si një qytetar të pidentifikuar të botës, kjo ndoshta edhe si rezultat i largimit prej shumë vitesh nga vendi ynë. Ky element mund të konsiderohet edhe si një avantazh i autorese, pasi me të ajo mëton t'i japë universalitet veprës së vet.

Fabulat janë të thjeshta, por të shkruar me një gjuhë shumë korrekte dhe me kompozicione që hera-herës tregojnë shumë kërkesë të autorese ndaj vetes, por edhe përpjekje të bukura në gjininë e vështrirë të tregimit.

"Erdhëm në këtë botë dhe dallimi i vajzës ishte bërë. Duhet të martohesh dhe të sjellësh në jetë një fëmijë, të cilët duhet të rriten, të martohen e të trashëgohen, ndryshe nga pas do të ndërniqin murmurimat e njerëzve: "e



pafata", "shterpa", "e gjora". Nuk kam dashur asnjëherë të plotësoj këtë rregull standard, "udhën e dhënë nga Zoti". Studime, martesë dhe fëmijë. Nuk bëra asgjë nga këto, thjesht, ngaqë nuk më duket se mi diktonte Zoti. Nuk do kem fëmijë! As të vë kujën nuk kam fuqi, lotët shterën. Nuk na edukoi kush me humbjen, por me fitore të shtirura, me një jetë në dukje më të mirë se ajo që jetonim. U rritëm duke gënjyer botën dhe, më e keqja se, mbi të gjitha, gënjem dhe plagosëm veten. Do të ikim nga kjo botë me një barrë dhimbjesh dhe të mëshiruar nga bota se kuptuam të vërtetat, por me një çmim të madh, atë të zhgënjimit. Çfarë më torturon është se mund ta kisha shpëtuar veten nga ky trishtim, kjo dhimbje, por egoizmi ishte më i fortë. Tani asgjë nuk ka më vlerë".

Autorja bën përsiatje interesante, falë një aftësie të lindur të imagjinatës dhe kjo është një nga armët e saj të forta që e tregojnë një subjekt që e ka të mbrujtur mirë mendimin e saj në letërsi.

Narratori qëndron ashtu si e thamë zakonisht në vetën e parë por ndërthuret natyrisht në vetën e tretë, gjë e bën autorën të menaxhojë sa më mirë subjektin e saj. Madje, në disa momente ajo e shkrëben narratorsin në gjini tjetër dhe kjo tregon një sfidë, që hera-herës i negoc, pasi duket më e gjithëfuqishme në gjininë e vet. Vërtetë kompozimi i tregimeve nuk është i komplikuar, por shtjellimi është i qartë, gjë që e tregon autorën se është e stërvitur kohë më parë para se të fillojë veprën e vet. Mimoza Kouchly duhet vlerësuar edhe në përpjekjen interesante që bën në kërkimin e subjekteve metafizike duke na dhënë realisht një autore me kërkesa të larta, ku synohet që përmes funksionit të letërsisë të shkohet në kërkimin e stadeve të ndryshme të gjendjes shpirtërore të subjekteve. Dhe, kjo realizohet këndshëm, paqsa se kalimi në regjistrin letrar do edhe pak punë. Megjithatë, imagjinata e saj nuk e lë në balte për të afruar sa më shumë gjendje të ndryshme të subjekteve.

Autorja është e ndërgjegjshme për detyrën e vështrirë të letërsisë, pas avancimit të shkencave që lidhen me psikologjinë, pasi ashtu si thotë Ana Ahmetova: Nuk ka më letërsi pas Frojdit! Ndaj, ajo me kujdes mundohet të mbajë një balancë të gjithë gjërave që e rrethojnë, ku synon ta respektojë sa më shumë psikologjinë e individit dhe të flasë më hapur për subjektet që lirin dhe barazinë e kanë si element parak të qenies të tyre. Personazhet e saj demonstrjnë në një farë mënyrë dhe nocionet e saj estetike për të bukurën, të lartën dhe të shëmtuarën. Në të gjitha kriter mbetet dinjiteti dhe ekuilibri i gjërave, elemente që autorja i zgjidh me kulturën e vet të mirë.

Autores i duhet që të jetë pak më e beftë në krijimtarinë e vet dhe të dhurojë me befasia përmes tregimeve të saj artistike. Sesa do t'ia dalë në të ardhmen mbetet për tu parë, por me këtë libër ka treguar se ka bërë një përpjekje të këndshme...për të bërë udhë të gjatë me lexuesit shqiptar.



Titulli: Rrëfej unë, gruaja  
Gjinia: Tregime dhe novela  
Autori: Mimoza Kuchly  
Shtëpia botuese: Onufri  
Viti: 2017  
Fq. 160  
Çmimi: 500 Leka

→ Vijnë nga faja 17

shtresë gërmimesh nuk janë gjetur shenja shkatërimi nga zjarre të shkatkuara si pasojë e përplasjeve konfliktuale.

E mira e përbashkët ishte parimi udhërrëfyes. Kushtet e balancuara të jetesës për të gjithë sollën arritjen e një shoqërie që vepron mbi bazën e bashkësisë, ku interesi i përgjithshëm qëndronte mbi atë individual duke mos favorizuar pasurimin privat. Të ardhurat e tregtisë ndaheshin në mënyrë të barabartë ndërmjet pjesëmarrësve në prodhim dhe në tregti. Prona komunale e kishte përpaësi.

Jehonën e së mirës së përbashkët si vlerë themelore të shoqërisë e gjejmë në teorinë politike të Platonit, mendimi i të cilit pasqyron elementet trashëgimie kulturore të Europës së Vjetër. Ndërmjet të tjerash, ai thotë se shprehja që nënkupton të mirën e përbashkët në greqishten e vjetër, *to agathon*, ka origjinë para-greke dhe është huazuar nga gjuha e mëparshme që flitej atje (në Athinë, si dhe në treva të tjera të Ballkanit jugor, duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë, njerëzit që flisnin këtë gjuhë u quajtën nga grekët Pellazgë).

Qytetërimi i pellgut Danubian, ku këto vlera themelore u shfaqën së bashku, lulëzoi në mënyrë të qëndrueshme për një periudhë 3000 vjeçare, që fillon rreth viteve 6000 dhe zgjat deri aty rreth viteve 3000 PES. Europës së Vjetër nuk i erdhi fundi nga fakti që kjo shoqëri ishte e paqëndrueshme. Rrjedha e ngjarjeve ndryshoi, mund të thuhet, nëpërmjet një *force majeure* (rasti madhor) që mori

# Errësirë? Aspak e tillë!

Një ftesë për rizbulimin e Europës së Vjetër dhe qytetërimin të saj rreth 8000 vjeçar në pellgun Danubian, si dhe vlerat themelore të mishëruara në të.

shkas nga migrimet e blegtorëve nomadë të cilët vinin nga stepat e Rusisë jugore. Këta ishin proto-indo-europianët.

Ata erdhën valë-valë në kohë të ndryshme, në rrajone të ndryshme të Europës. Në terma të përgjithshëm, përgjatë mijëvjeçarit të tretë PES, përta përkat Ballkanit, grekët u vendosën në Hellas, trakët në Bullgarinë e sotme dhe Ilirët në zonën e Ballkanit perëndimor. Çfarë ndodhi pastaj është aktualisht objekt studimesh intensive, por duket qartë që trashëgimia kulturore e Europës së Vjetër (së bashku me vlerat e saj thelbësore) u shkri me traditat Indo-europiane. Këto të fundit përfshinin gjithashtu hierarkinë shoqërore dhe konfliktet e armatosura, që nomadët e ardhur nga stepat e futën në shoqëri në e europiane.

Dy fjalë të greqishtes së vjetër e reflektojnë shumë mirë këtë përmbysje kulturore: *amilla* që do të thotë "kompeticion paqësor" dhe *eris* që do të thotë "konflikt i dhunshëm, përbalje ushtarake". *Amilla* ka origjinë para-greke dhe nënkupton konkurrencë paqësore në tregti ose gara sportive. *Eris* ka

origjinë greke (indo-europiane) dhe përdoret për të përshkruar luftrat e shumta civile të grekëve.

Një fjalë tjetër greke e huazuar nga Europa e Vjetër është *eirene* që do të thotë "paqe". Ndoshta, huazimi i kësaj fjale ka rrjedhur si rezultat i përplasjeve të dhunshme e të vazhdueshme të cilat mund të kenë evokuar nostalgjinë për periudhën e gjatë paqësore të Europës së Vjetër, apo më thjesht, si nevojë për të shprehur një koncept që grekëve indo-europianë iu mungonte. Në çdo rast, kemi një shprehim të mundshëm për huazimin në gjuhën greke të një koncepti kaq kyç siç është *eirene*.

A ka sot një trashëgimi të Europës së Vjetër? Padyshim që ka, për më tepër në një vend si Shqipëria, që siç përmendëm më lart shtrihet tërësisht brenda territorit të atij qytetërimi jetëgjatë të lashtësisë. Madje mund të themi se Shqipëria zë një vend gjeografikisht të rëndësishëm për kërkimet arkeologjike në hapësirën ku u zhvillua kultura e Europës së Vjetër dhe njëkohësisht është edhe vendi më pak i studiuar në këtë aspekt. Po kështu, ndryshe nga vende të tjera

ish-komuniste, as sot nuk kryhen studime etnografike në Shqipëri, ndërkohë kur elementet e mundshëm që burojnë nga kultura e asaj kohe të largët mund të jenë ende të gjallë në kulturën popullore. Nga ana tjetër, familjarizimi me idenë e të jetuarit sot në një truall që mban nën vete gjurmë kaq të lashta të historisë botërore, atë të Europës së Vjetër, do të thotë të rrisësh sensin e përgjegjësisë së shqiptarëve dhe, para së gjithash, atë të shtetit me qëllim që të ndikohet në politikë që ai ndjek.

Së fundi, nëse do të shohim Europën e Vjetër dhe të njohim vlerat tona themelore në të, mund të përfitojmë elementet e saj positive dhe të nxjerrim mësimë të dobishme. Qytetërimi i pellgut Danubian ka hedhur dritë në historinë e njerëzimit si dhe mund të hedhë edhe më shumë. Për ne, në të tashmen, ajo mund të duket tepër larg dhe ndoshta me ndriçim të zbehtë – por sidoqoftë është një burim drite për t'u ndjekur. Është një lloj drite që mund të na udhëheqë majde edhe në ndërtimin e modeleve të ardhshme për Bashkimin Europian. [Fund]



Opinion *i* Ditës

# Diktatura e propagandës nuk e do arsimin!

Nga Jorida Tabaku

(vijon nga faqja 1)

...Kjo jo vetëm për cilësinë e deputetëve që ka afruar në radhët e mazhorancës, që janë të lidhur me botën e kirit më shumë se me atë të dijes apo arsimit, por edhe nga buxhetimi i arsimit. Tashmë është praktikë e qeverisë "Rama" që të buxhetojë shumë herë më pak se sa qeveritë e shkuara për arsimin, buxheti i arsimit është sot 2.3% e GDP-së, ndërsa investimet për shkollat të reja janë inekzistente.

Këtu nuk po përfshij investimet në fushën e dijes si biblioteka, abonime në revistat prestigjioze shkencore apo kushte të tjera, që hyjnë në një luks që Rama ua siguron vetëm ministrave të caktuar. Jo, e kam fjalën për investimet infrastrukturorë si dhe çeljen e një procesi, që do të mundësojë krijimin e një brezi të shëndetshëm intelektualisht për të ardhmen. Para dy vjetëve qeveria e Rilindjes "Rama" rrihte gjoksin për arritjet e qeverisë demokratike, që u vlerësua edhe nga sistemi PISA. Por, është shumë e qartë që me mungesën e mësuesve cilësorë, emërimeve politike dhe mungesës së meritokracisë shoqëruar me kushtet e turpshme infrastrukturorë, vlerësimi i PISA do të jetë negativ për rinjtë e shkolluar në periudhën e errësirës "Rama 1" dhe "Rama 2".

Nëse arsimit i ciklit fillor dhe ciklit të mesëm është në gjendje



të mjeruar, tragjedia shoqëruar me komedi në ciklin e lartë arsimor është edhe më lebetitëse. Kryeministri, i cili përpiqet të shfaqë kulturën dhe civilizimin e tij për të mbuluar dështimin e tij në arsimin e lartë, nuk mund të fshehtë dështimin e turpshëm të Reformës në Arsim. Një reformë që mbylli 130 shkolla, 20 degë dhe që shtyu të rinjtë të lar-

gohen.

Edhe ato pak studentë që vijnë në universitetet shtetërore përballen me tarifa marramendëse, që rriten për vit, ndërsa familjet shqiptare varfërohen për vit. Që pas reformës në arsim një familje shqiptare shpenzon nga buxheti i saj familjar 4% të gjithë të ardhurave, ndërsa përpara reformës shpenzonte 2% të të

ardhurave. Një rritje me mbi 1500 lekë për të ardhurat që zvogëlohen si pasojë e taksave dhe tarifave. Sakaq, universitetet që ndikuan në krijimin e reformës vazhdojnë të përfitojnë më shumë të ardhura dhe studentët më cilësorë.

Sakaq, nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme paguajnë sot libra shkollorë që kushtojnë

7.3% më shumë se sa një vit më parë dhe sipas të dhënave të INSTAT, gjithnjë e më shumë familje shqiptare heqin bukën e gojës për të mbajtur në shkollat fëmijët e tyre. Oligarkët e qeverisë ndërkojnë fitojnë miliona euro nga tenderat, koncesionet, PPP-të dhe gjithfarëloj shpikjesh, ndërsa qytetarëve të vendit u mohohet e drejta bazë e arsimit. Shqiptarët varfërohen, lihen pa shkollë dhe në inorancë të thellë, ndërsa buxheti i shtetit trajtohet si tepsia personale e mazhorancës.

Një Shqipëri që paguan më shtrënjtë tarifën, taksat, librat e fëmijëve, tarifën e shkollimit duke marrë në këmbim më shumë arrogancë, propagandë dhe sjellje gangsterësh. Kjo padyshim nuk është Shqipëria që duam ne, por Shqipëria që do të ndërtojë Rama dhe klientët e tij.

Në Shqipëri nuk ka biznese të teknologjisë dhe zhvillimit, sepse sistemi arsimor po degradon përditë e më shumë. Të rinjtë nuk shkollohen sepse askush nuk u ofron mundësinë të zhvillojnë dijen e tyre. Ajo çfarë i intereson qeverisë është një popull i paditur me shpresën se kështu mund ta komandojë më thjeshtë. Por, historia ka treguar që askush nuk mund të shtypë një popull duke e lënë në errësirë, pasi dija ka përherë një rrugë për të gjetur njeriun. Investimi në arsim është vetëm hapi i parë për të rikthyer shpresën tek të rinjtë, e këtë nuk mund ta presim nga qeveria e padijes! E kanë treguar!

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion i Ditës

# Vjeshta e stuhishme e Angela Merkelit

Kay-Alexander Scholz

(vijon nga faqja 1)

... të vjetër, thotë gazeta "Welt". Merkel mbajti një fjalim me vetëkritikë, por edhe me dëshirën për kundërsulm. E pikërisht para Unionit të Rinjve të CDU-së, që paraqitet më konservator se partia mëmë dhe prej kohësh ndjek një kurs opozitar kundër kancelares. Ndaj Merkelit në fundjavë pati kritika, por jo revolucion. Një pikë në avantazh për kancelaren.

## ORA PO TROKET, POR SA SHPEJTT

Merkel është mësuar me kritikën ndaj saj. Në fillim të mandatit të parë si kancelare në vitin 2005 thuhet se Merkel nuk është aq e pjekur politikisht për detyrën e kancelares. Në vitet e mëpasshme u zhvilluan zgjedhje me humbje për CDU, por Merkel mbeti në pushtet. Në shumë raste, ajo dëshimtimet e saj i ka zgjidhur duke "ndenjur", siç thonë gjermanët. Këtë e kujtojnë jo pak vetë këto ditë në Berlin, kur - ndoshta me nxitim - bëhet thirrje për fundin e kancelares.

Që fundi një çast vjen, këtë e dinë të gjithë. Çështja që shtrohet është se kur? Merkel vetë thotë, se ajo është e zgjedhur për këtë legjislaturë dhe ajo zgjat deri në vitin 2021. Por ajo do ta moderojë mirë transferimin e pushtetit, thonë shumë vëzhgues, ndoshta në mesin e mandatit. Në fund të fundit bëhet fjalë edhe për trashëgiminë e saj si kancelare. Por shumë spekulojnë se krizat e deritanishme në koalicionin qeveritar do ta thyejnë kancelaren e do ta bëjnë të largohet. Dhe kritikë bëhen gjithnjë e më zë më të lartë.

## KËRKOHEN PASUES PËR MERKELIN

Ajo që të bën të jesh pro transferimit të rregullt është se nuk ka asnjë pasues aq karizmatik që mund t'i mbledhë kritikët e Merkelit. Politologu Wolfgang Merkel mendon se, "nëse Merkel nuk reziston, atëherë unioni ka një problem të madh". Nuk ka një "figurë bindëse". Megjithatë, trazirat kërcënojnë të vijnë. Sepse nga kjo fundjavë Merkelin e përfshin një stuhë politike.

Zgjedhjet në Bavari, ku partia simotërë CSU duket se mund të pësojë një humbje historike. CDU qeveris prej vitësh me shumicë absolute. Ndërkohë në sondazhe ajo kap tani rreth 35% të votave. Mund të ketë jo pak veta që do t'ia hedhin Merkelit fajin për këtë dështim. Kryetari i CSU-së, Horst Seehofer është edhe ministër i Punëve të Brendshme.

Dy javë më vonë pasojnë zgjedhjet në landin e Hesenit. Atje qeveris CDU me të Gjelbrit, e ky koalicion me gjasë mund të mos zgjid-



het më. Kjo do të ishte një tjetër goditje për kancelaren.

## PROBLEME NË PËRGJITHËSI TE PARTITË POPULLORE

Që sondazhet kanë vlera të tillë kaq të dobëta lidhet me konfliktet e hapura në qeveri. Rasti tipik ishte mënyra e veprimit mes ish-presidentin e Mbrojtjes Kuschetuese, Hans-Georg Maaßen. Në Gjermani vlen parimi i unitetit. Vetëm kështu binden votuesit.

Por megjithatë, partitë popu-

lores të njohura si ajo konservatore dhe SPD po zvogëlohen gjithnjë e më shumë. Ndërkohë të Gjelbrit liberalë dhe partia populiste, AfD po shtojnë votat. Disa madje i shohin këto parti si partitë e reja të forta në plan afatgjatë. Ato janë pole të konfliktit të ri për globalizimin - thotë politologu Werner Patzelt.

Që pushteti i Angela Merkelit dobësohet e tregon këto ditë edhe në një intervistë të depu-

titit të CDU-së dhe mjaft i fuqishëm tek konservatorët në landin Renani Veriore dhe Vestfali. Në një intervistë për Spiegel, ai kërkoi ndryshime strategjike dhe personeli.

Kritika vijnë edhe nga ministri aktual i Shëndetësisë, Jens Spahn dhe Carsten Linneman, kreu i Shoqatës së Ekonomisë të CDU/CSU-së. Edhe 50-vjeçari Ralph Brinkhaus, që fitoi papirur kundër të preferuarit të Merkelit, Volker Kauder postin e kreut të grupit parlamentar, vjen nga landi Renani Veriore-Vestfali.

Pas tejkalimit të zgjedhjeve në dy lande, Merkelin e pret sfida tjetër politike. Kongresi i Partisë Kristiandemokrate, CDU në dhjetor. Merkel do të kandidojë sërish. Por kësaj here ka kundërkandidatë tre politikanë, por politikanë nga radha e katërt. Koka të CDU-së, si Wolfgang Schäuble kanë bërë të ditur, se do të duan të kenë Merkelin si kryetaren e partisë.

Pra, nuk mund të mos e vësh se po punohet për epokën pas Merkelit. Por, Merkel ende ka një bazë të fortë në presidiumin e CDU-së dhe mes ministrave konservatorë.

## HOROSKOPI

### DASHI

Sot do të arrini në një konkluzion në lidhje me çështjet familjare apo me mënyrën se si do të arrini të bëni edhe një lëvizje të fortë në çështje të karrierës.

### DEMI

Një ditë paksa me tensione midis jush dhe personave që janë pjesë e shoqërisë suaj, pasi nuk do të gjeni mirëkuptim për gjërat që doni të bëni. Në të tilla situata duhet të tregoheni tolerantë.

### BINJAKET

Sot do të jeni të papërbajtur në lidhje me mënyrën se si do veproni apo do t'i thoni gjërat. Ka mundësi të mos jeni aspak diplomatë dhe kjo do t'ju krijojë disi më shumë probleme.

### GAFORJA

Ditën e sotme do ndjeni se ndryshimet që bëhen rreth jush nuk janë aspak të këndshme, por të detyruara nga persona që ju i mendoni si kundërshtarë apo nga presioni që mund t'ju bëhet për të bërë ndryshime.

### LUANI

Ditë e mirë për të dashuruarit. Do jeni më të lidhur se kurrë me partnerin. Sa u përket parave, të gjitha mundësitë janë të mira, por duhet të dini si t'i kapni këto mundësi.

### VIrgjeresha

Dita e sotme në përgjithësi do jetë shumë e fortë në lidhje me anën ekonomike. Në fakt, duke parë se do ju duhen më shumë para, atëherë do detyroheni të jeni edhe mënyra të tjera për t'i fituar.

### PESHORJA

Ditën e sotme ka disa çështje që ju nuk i keni zgjidhur apo logjikuar siç duhet si në lidhje me qëllimet tuaja, ashtu edhe në lidhje me jetën tuaj personale. Sa u përket parave, bëni kujdes me shpenzimet!

### AKREPI

Dita e sotme në planin e karrierës dhe të familjes do mbart tension apo acarim. Ka mundësi që t'ju duhet të jeni më afër familjes. Në planin financiar, jo gjithçka është në rrugën e duhur.

### SHIGJETARI

Sot do të keni shumë shpenzime, të cilat me sa duket nuk i prisnit dhe do t'ju duhet të filloni të bëni plane për të fituar më shumë. Do të keni ide të reja dhe kjo do t'ju ngrejë moralin.

### BRICJAPI

Po mendoni që të bëni disa ndryshime në jetën sentimentale. Kujdesuni që gjithçka të bëhet me kujdes në çdo detaj. Dikush mund të përpiqet të përfitojë në kurrizin tuaj.

### UJORI


Ditën e sotme një konflikt apo një incident i vogël mund t'ju sjellë pasoja. Përpikuni të shmangni përplasjet me një koleg, i cili ka më shumë mbështetje sesa ju.

### PESHQIT

Prezenca e Hënës sot në shenjën tuaj ndoshta do t'ju bëjë që të jeni më të ndjeshëm ndaj kërkesave të të tjerëve. Kjo do të bëjë që disa zakone në jetën tuaj të ndryshojnë.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Miller e Verdi-t.
5. Më e mira është rektor.
9. Inicialet e Derain.
11. Kishte 100 Teba.
12. Është vija e portës
13. Në fund te rritjes.
14. Drejtori Lokale Përmet.
15. Inicialet e Seagal.
16. King Cole i muzikes.
17. Ishte shpendi simbol i Jezu Krishtit.
21. Artikulli spanjoll.
23. Janë fjalëpakë.
25. Fillojnë titrat.
26. Është i mërzitshmi.
27. Ashtu si jeton heremit.
29. U kompozua nga Ravel.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.

32. Një kitarë indiane.
33. Janë edhe ato të sigurimit.
35. Është e harlisur në xhungël.
37. Mbyllin fushatat.
38. Kështu thirrej Eisenhower.
40. Ai dhe ajo.
41. Fillojnë vallen.
42. Inicialet e Defon.
44. Kalohet në gjumë.
45. Martini që që këngëtare
46. Një thirrje me emra.

**VERTIKAL**

1. U quajt qyteti atomik.
2. Qyteti i Abrahamit.
3. Italia në tabela.
4. Sapo fillojnë.
5. Nemo ai i Nautilus.
6. Janë në botë
7. Një tabu islamike
8. I famshmi Pacino.
10. Janë si falimentime
11. Ngjyhet një në tavolocë.
12. Timo i Mato Grudës.
14. Janë borxhlinj.
17. E përditshmja që ke në dorë.
18. Carson i fumetti-t.
19. U shkrua nga Sartre.
20. Në fund të vitit.
22. Është lloj poezie.
24. Janë shtëpi... qeni.
25. Janë kapriçiot.
27. Verifikuar pjesërisht.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Është sekrete në derë.
34. Kodi i celularit.
36. Daja i Amerikës.
39. Kaluar në krye.
43. Fillojnë detyrën.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Atkinson, alias Mister Bean.
5. Ishte dyqanxhi i dikurshëm.
10. Ferrara regjisor.
12. Kalohet në gjumë.
14. Të parat në sondazh.
15. Është nofka.
16. Një treshe në skenë.
19. Nuk i tregohen babait.
21. Gjysmë tatimi.
23. Berenger aktor.
24. Në mes të një forme.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Fillojnë nazet
29. Kalimi në kufij.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Është zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.

**VERTIKAL**


1. Është edhe ajo amërore.
2. Është edhe ai mbretëror.
3. Të parat në Wellington
4. Një vegël
6. Është vendi aderues
7. Është emirat.
8. Mbyllin portat.
9. Pak latinisht.
11. Janë zjarrvënës.
13. Qyteti i perjetshëm.
17. Kufizojnë rastet.
18. Shkroi Këngëtarja tulleco.
20. Inicialet e Moravia-s.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Është logjarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Janë kapot.
40. Numri i oktetit.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Fillojnë tjetrën.
48. Derisa janë në fund.
49. Inicialet e Taylor aktore.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			5					
		1			2		3	
9	1		3	7				
		7	1	3			8	
					4			
					6		2	
2	5							
	1	9		4	8			
7	4		6	8		5		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	2	7	9	1	8	3	6	5
1	3	5	2	6	7	9	8	4
6	8	9	4	3	5	1	7	2
9	7	2	5	8	4	6	1	3
8	4	6	3	2	1	5	9	7
5	1	3	7	9	6	2	4	8
3	9	1	8	7	2	4	5	6
7	6	4	1	5	3	8	2	9
2	5	8	6	4	9	7	3	1

*Argëtim filozofik*

- Jeta e bejme nga ato që marrim, jetën e bejme nga ato që japim.
- Sir Winston Churchill (1874 - 1965)
- Jeta e pakontrolluar s'ia vlen të jetohet.
- Sokrati (469 BC - 399 BC),
- Jeta është një seri e pathyter situatash të rrejtshme.
- Thomton Wilder (1897 - 1975)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	H	I	J	A		12	7		7	8	6	11	K	U	L	T	M	A	P	L	A	B			
1	4	3	8		10	1	14		5			1	8	O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R	
18	1	8			5	3	9	3	8	2	12	2		R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E
2	8			5	6	4	6	9	1	9	2		5	B		K	L	E	O	P	A	T	R	A	
8		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3		I	E	K	I	T	R	E	T	E	S		
6	1	11		12	9	1				8		9	11	L	E	R	M	E	K	E	R	M	A	T	
9	3	1		2	6		7	16	2		1	3		T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E	
3		7		4		1	8	6		8	2	14		O	T	O	S	C	I	R	M	A			
	13	2	7	7		15	6	3	11		4	6		B	R	E	D	H	I	A	I	R	K		
4	2	12	2		5		11		1	13	3	17		I	L	E	I	N	E	P	H	I	L		
1	4	3	7	8	3	20	2	7	6		8	1		A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I
8	1			18	1	9	1	12	1		2	8		S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

M A K U T E R I T I M  
 A G A R R E N D M I K E  
 L I T A R E T E S O  
 E M I L E A P E L I M I  
 E L E D E P O Z I T A T  
 A T E K A P A N O N E T  
 E S S E N D A M E A N A M  
 C I F A M O T E E M E R A  
 M I K A T E T E T I L  
 K O R R I K U K O L E L A  
 U N A Z A R E N D O R E

**FJALËKRYQI (2)**

M T R A N D A B I S H T I  
 I R A A R M A D H I D  
 T O A P A R A T E I A E  
 I N R I M O T E E M E R A  
 I R D A M A R E T I L  
 I A K O T A N T O D  
 M K A B I N E T E R A R  
 P U R T E K E E T N I K E  
 P E R S E T I N T I M  
 L A O I G O L A L A  
 I H R T P E T E R I K  
 V O L E E L E N D E E

*Thënie të mençura*

- Jeta është vetëm një pasqyre, dhe atë që sheh aty duhet patjetër ta shohesh njëherë brenda vetes.
- Wally 'Famous' Amos (1936 - )
- Jeta s'është e drejtë. Është vetëm me e drejtë se vdekja, kaq.
- William Goldman, "The Princess Bride"
- Qëllimi i jetës është të jetosh në pajtim me natyrën.
- Zeno (335 BC - 264 BC),
- "Fatqesitë tregojnë kush janë shoqe të vertete.

